

STRATFOR

Rivaliteti  
Rusi-Perendim  
ne Ballkan



INVESTIGIMI

Kosove e Bosnje,  
mes eksportuesve  
te zhihadisteve



VICTOR HANSON

Terheqja e SHBA  
ne skenen globale  
trokitje ne lufte

# Politika

Botim elektronik i ASP ne bashkepunim me Bota.al-Qershor 2015



# Katër lojëra që mund të jenë duke luajtur grekët



**Programi i Shkollës së Studimeve Politike financohet nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri si edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve**



## Botim elektronik i Akademisë së Studimeve Politike në bashkëpunim me Bota.al

**bota.al**

Friday, June 20, 2014

HOME BOTA EKONOMI TEKNOLOGJI HISTORI SHKENCE KULTURE DOSSIER SPORT

### INTERVISTA/Habermas: Propozimi im për një Union më demokratik

Jürgen Habermas është sociolog dhe filozof gjerman, i traditës së teorisë kritike dhe pragmatizmit. Ai është bërë i njohur për teoritë e tij të racionalitetit të komunikimit dhe sferës publike. Sipas sondazheve globale, Habermasi pranohet gjerësisht si një prej...

June 19, 2014

### BOTIMESHQIP.COM

Në Shqipëri ju i merrni librat brenda 24 orëve dhe i paguani lehtë në dorë kur merrni librat.

Në çdo vend tjetër të botës ju i merrni librat brenda pak ditësh dhe mund të paguani me PayPal, transferë bankare, etj.

**botimeshqip.com**  
Libri Shqip në shqipëri tani!

**Kontaktet:**  
Akademia e Studimeve Politike  
Adresa:  
Qendra Kotoni,  
Rr.Donika Kastrioti,  
Nr.3,  
Kati 4, Zyra 2,  
Tirane, Shqipëri  
Tel: +355 4 227 2173,  
Tel: +355 4 450 4788  
E-mail: [info@asp.al](mailto:info@asp.al)  
Web: [www.asp.al](http://www.asp.al)  
dhe [www.bota.al](http://www.bota.al)

**Përzgjedhja, redaktimi dhe përkthimi i materialeve në këtë buletin kryhet nga alumni i Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, z. Ermal Gjinaj**



**Një prej “dënimeve” që merr kur refuzon të marrësh pjesë në politikë, është se përfundon duke u qeverisur nga ata që janë inferiorë ndaj teje.**

*Platoni*

**Vendi më i nxehtë në Ferr u është rezervuar atyre që qëndrojnë neutralë, në kohëra konflikti të madh moral.**

*Martin Luther King Jr.*

**Politika është luftë pa gjakderdhje, ndërkohë që lufta është politikë me gjakderdhje.**

*Mao Cedun*

**Njeriu është nga natyra një kafshë politike.**

*Aristoteli*

**Nëntëdhjetë përqind e politikanëve i japin dhjetë përqindëshit tjetër një reputacion të keq.**

*Henry A. Kissinger*



# GJEOPOLITIKE / Analiza e “Stratfor”: Rivaliteti mes Ruisë dhe Perëndimit në Ballkan

*Kundërvënia e Ruisë ndaj Perëndimit. Interesat e Turqisë.  
Dhuna në Maqedoni. Sfidat e mëdha rajonale, në një rajon ku  
rivalitetet gjeopolitike dhe mosmarrëveshjet lokale kanë qenë  
historikisht një kombinim shpërthyes*

“STRATFOR”

---

Rusia, Turqia dhe Perëndimi, të gjitha përballen me një rival në Ballkan: paqëndrueshmërinë politike. I gjendur në pikëpjekjen e tre perandorive historike, rripi i tokës midis Mesdheut dhe Detit të Zi ka qenë prej një kohe të gjatë fokusi i konkurrencës mes fuqive globale. Tani është thjeshtë një arenë në “përplasjen e brirëve” mes Ruisë dhe Perëndimit. Megjithatë, teksa të dy palët përpiqen të blejnë influencë me investime dhe projekte energjetike, dhe Turqinë që mundohet fort për të kapur ritmin, sfidat e brendshme politike rrezikojnë të hedhin në erë përpjekjet e bëra nga jashtë për të zhvilluar rajonin. Teksa fuqitë e mëdha përdo-

rin fuqinë e tyre financiare dhe politike për të fituar influencë në Ballkan, qeveritë e dobëta lokale do të vazhdojnë të ecin në “traun e ekuilibrit” mes kombeve që konkurrojnë midis tyre.

#### Analiza

Kohët e fundit, fuqitë rajonale dhe botërore i kanë kushtuar një vëmendje tepër të madhe vendeve të Ballkanit. Në 15 maj, Ministri i Jashtëm i Ruisë, Sergei Lavrov vizitoi Serbinë, vetëm pak ditë pasi Kryetarja e Këshillit të Federatës Ruse, Valentina Matviyenko u takua me udhëheqësit serbë në Beograd. Presidenti i Turqisë, Rexhep Taip Erdogan do të vizitojë Bosnje Hercegovinën në 20 maj - ministri i Jashtëm turk, Mevlut Cavusoglu dhe zëvendëskryeministri, Ali Babacan kanë bërë vizita të ngjashme muajin e fundit. (Pak ditë më parë Erdogani vizitoi edhe Shqipërinë). Udhëheqësit perëndimorë kanë demonstruar gjithashtu një interes të madh për rajonin, teksa Sekretari i Shtetit i SHBA, John Kerry dhe Sekretari i Jashtëm Britanik, Philip Hammond, vizituan Bullgarinë në janar, ndërkohë që zyrtarë të lartë të SHBA vizitojnë rregullisht Rumaninë.

Investime strategjike nga Perëndimi  
Qeveritë perëndimore kanë dy objektiva madhorë në Ballkan: të ruajnë stabilitetin në pjesën perëndimore të rajonit dhe të minimizojnë influencën e Ruisë. Për këtë qëllim, SHBA dhe BE janë përfshirë në politikat e brendshme të vendeve të Ballkanit, që kur NATO dërgoi trupa pas luftës së Bosnjës dhe konfliktit në Kosovë, në vitet 1990. Trupa perëndimore vazhdojnë të shërbejnë në Kosovë, në cilësi paqeruajtëse. Bashkimi Europian ka përdorur një sasi të konsiderueshme burimesh dhe kapitali politik për të sjellë reforma dhe zhvillim ekonomik në rajon, por rezultatet kanë qenë të përzierë.

Perëndimi ka avantazhin e qasjes në sasi të mëdha fondesh për zhvillim dhe për mbrojtjen, të cilët mund të ndahen mes vendeve të “uritur” për rritje ekonomike. Vende si Serbia dhe Maqedonia nuk ka gjasa që t’i bashkohen Bashkimit Europian gjatë dekadës së ardhshme; ato frenohen prej ndarjeve të brendshme dhe ndeshin në rezistencën e anëtarëve aktualë të BE-së. Megjithatë, ato gjithësesi përfitojnë prej të mirave ekonomike që vijnë prej lidhjeve të ngushta me Europën. Mes viteve 2014 dhe 2020, Bashkimi Europian ka në plan të japë 1.5 miliardë Euro për Serbinë, një vend që aspiron për anëtarësim, dhe 11.4 miliardë Euro për Bullgarinë, një vend anëtar. (Qytetarët bullgarë përfitojnë prej mundësisë për të udhëtuar lirisht dhe kërkuar punë në vendet e BE). Po kështu, ka një sasi domethënëse ndihme për mbrojtjen që shkon për Bullgarinë, si pjesë e një përpjekjeje për të forcuar anëtarët e NATO-s përgjatë kufirit me Rusinë.

Kriza e Ukrainës i galvanizoi Shtetet e Bashkuara, për të forcuar mbrojtjen përgjatë skajit lindor të NATO-s. Aleanca e Atlantikut të Veriut ka zgjeruar forcën e saj shumëkombëshe të reagimit, ka krijuar një forcë të re të mobilizimit të shpejtë dhe ka krijuar një zinxhir avanpostesh në Ballkanin lindor, të quajtura njësitë e integritit të forcës, që shërbejnë si qendra komande gjatë një konflikti.

Në të njëjtën kohë, luftimet në Ukrainë shtynë Bashkimin Europian që t’i japë prioritet projektit të gazsjellësit të Korridorit të Jugut, i cili do të anashkalonte gjigandin energjetik rus, Gazprom, në tregun energjetik europian si dhe do të

***Perëndimi ka avantazhin e qasjes në sasi të mëdha fondesh për zhvillim dhe për mbrojtjen, të cilët mund të ndahen mes vendeve të “uritur” për rritje ekonomike. Vende si Serbia dhe Maqedonia nuk ka gjasa që t’i bashkohen Bashkimit Europian gjatë dekadës së ardhshme; ato frenohen prej ndarjeve të brendshme dhe ndeshin në rezistencën e anëtarëve aktualë të BE-së***

reduktonte varësinë e Europës nga Rusia. Po kështu, Perëndimi i kërkoi me forcë Bullgarisë që të mos marrë pjesë në projektin e Rosisë, "South Stream". Kur Bullgaria u tërhoq, Rusia shpalli anulimin e projektit në dhjetor. Rusia i kundërvihet Perëndimit

Nga ana e saj, Rusia ka përdorur influencën e vet në Ballkan, aty ku ka lidhje të ngushta historike dhe kulturore me vende si Serbia dhe Greqia, për të kërcënuar interesat e Perëndimit. Megjithatë, interesi i Kremlinit në rajon gjatë vitit të fundit, buron pikësisht prej përkeqësimit të marrëdhënies së tij me Perëndimin. Objektivi i Rosisë në Ballkan është që të pengojë zgjerimin e trupave perëndimore dhe infrastrukturës ushtarake në rajon, ndërkohë që të ruajë forcën e mjaftueshme për të vënë në zbatim projekte strategjike të infrastrukturës energjetike.

Ndonëse perëndimi ka më shumë burime për të investuar në Ballkan, Rusia zotëron shumë asete rajonale energjetike dhe ka disa hua ende të papaguara që ia ka dhënë qeverive të vendeve të Ballkanit. Moska ia ka dalë që të ruajë marrëdhënie të mira diplomatike me disa oligarkë lokalë, sidomos në Bullgari. Në vitin 2008, Gazpromi bleu shumicën e aksioneve në kompaninë serbe të naftës, NIS. Ashtu si Bashkimi Europian, Rusia i ka ofruar fonde Serbisë - afro 1.5 miliardë dollarë gjatë dy viteve të fundit. Kremlini firmosi gjithashtu marrëveshje energjetike dhe huash me Republika Srpska, entiteti etnik serb në Bosnje-Hercegovinë. Trysnia e Perëndimit mund t'i ketë dhënë fund projektit South Stream, por

gazsjellësi që Rusia vendin e tij, Turkish Gazpromin që të e europianëve për të energjisë. Gazs-gaz natyror përgjatë turko-grek. Për të arrijë tregjet e Europës ndërtimin e një gazs-Greqia në Maqedoni, Turqisë, këta katër ofensivës diplomatike Rusia përpiqet fort brendshme financiare manovrimit në Ballkan

Interesat e Turqisë Turqia ka lidhjet e saj ekonomike në Ballkan, por aktualisht asaj i mungojnë burimet dhe fuqia ushtarake për të rivalizuar Rusinë dhe Perëndimin.

Një prej objektivave strategjike të Turqisë është të ruajë influencën në Detin e Zi. Historikisht, Ankaraja e ka arritur këtë gjë duke u ankoruar në Danub. Ky objektivi kërkon menaxhim të marrëdhënieve me shtete të tjerë të Ballkanit që lagen nga Deti i Zi. Por Turqia po përpiqet të afrohet gjithashtu me Bosnje Hercegovinën, ku Ankaraja synon të rrisë ndikimin e saj përmes lidhjeve kulturore dhe historike. Këto lidhje janë të rëndësishme: Boshnjakët myslimanë nisën të migrojnë drejt Turqisë në shekullin 17, dhe janë disa milionë qytetarë turkë që sot thonë se kanë rrënjë boshnjake. Kjo afërsi etnike ka nxitur nisma të vazhdueshme qeveritare për të investuar në Bosnje Hercegovinë.

Turqia nuk mund të arrijë nivelin e investimeve financiare që fuqitë Perëndimore dhe Rusia angazhojnë në Ballkan. Por, si "portieri" për në Detin e Zi dhe si vend anëtar i NATO-s, Turqia luan një rol të rëndësishëm në përpjekjet e Bullgarisë dhe Rumanisë për të rritur bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, si përgjigje ndaj krizës në Ukrainë. Po kështu, Turqia ia ka dalë që të përdorë mjete financiare dhe politike për të siguruar favore në Bosnje. Turqia është mes pesë investitorë-

***Turqia ka lidhjet e saj kulturore dhe interesat ekonomike në Ballkan, por aktualisht asaj i mungojnë burimet dhe fuqia ushtarake për të rivalizuar Rusinë dhe Perëndimin***

ka në plan të ndërtojë në Stream, mund të ndihmojë kundërpeshojë përpjekjet diversifikimin e burimeve jellësi do të transportonte Detin të Zi, deri në kufirin ndihmuar Gazpromin që të Qendrore, Rusia ka mbrojtur jellësi që do të kalonte nga Serbi dhe Hungari. Përveç vende janë në qendër të ruse. Megjithëkëtë, teksa për menaxhimin e sfidave të dhe politike, hapësira e saj e është relativisht e kufizuar.

kulturore dhe interesat eko-

ve kryesorë në vend. Në fakt, zyrtarët turq pretendojnë se Turqia ka investuar 1.1 miliardë dollarë në Bosnje, që nga viti 1995 - një shumë e madhe kjo për një vend, GDP-ja e të cilit është 18 miliardë dollarë.

Gazsjellësi Turkish Stream, nëse ndërtohet, padyshim që do të fuqizojë Turqinë. Ankaraja do të luante një rol qendror në ndërtimin e tij, dhe do ta përdorte atë rol për të përmirësuar marrëdhëniet e saj me vende që do të merrnin gaz natyror prej Turkish Stream, duke përfshirë Maqedoninë dhe Serbinë.

Dhuna në Maqedoni

Pavarësisht vëmendjes që tërheqin prej fuqive të mëdha, vendet e Ballkanit janë shpesh herë të paqëndrueshëm, dhe paqëndrueshmëria e tyre mund të pengojë ndikimin e fuqive të huaja. Për shembull, në 9 maj shpërtheu dhuna në Maqedoni, kur trupa të Ministrisë së Brendshme sulmuan, ata që sipas tyre ishin militantë etnikë shqiptarë në Kumanovë, gjë që arriti kulmin me vdekjen e 8 policëve dhe 14 prej atyre që qeveria i quan militantë. Afro 40 policë u plagosën dhe 30 militantë u arrestuan. Ka edhe lajme, të pakonformuar, për viktima në civilë.

Qeveria e Maqedonisë argumentoi se ky operacion në qytet u krye për të mos lejuar që militantët të

në vend. Megjithatë, operacionit shtyu se ai ishte i motivuar drim që do të largonte i paligjshëm i përgjime-Gjakderdhja në Kuzbulimet për përfitim cioneve mbi qytetarët, besueshmërinë e një qe-e kishte humbur besit-17 maj, dhjetëra-mijëra në kryeqytetin maqee nxitura nga perëndinuk arritën një kompartive opozitare, e si mbetet i brishtë.

Rusia po llogarit që gazsjellësit Turkish drejt Europës qendrore, në vend rrezikon këta vendet e tjerë, që ndod-alternative të një mirëpresin propozimet e në pushtet, e gjendur

BE, është kundër pjesëmarrjes në një projekt energjetik që udhëhiqet nga Rusia, ndërkohë që Shqipëria ka një orientim properëndimor të politikave të saj.

Duke qenë se steka është kaq lart, Ministria e Jashtme e Ruisë mbështeti me forcë qeverinë e Maqedonisë, në përgjigje të protestave. Ministria kritikoi partitë opozitare dhe grupet joqeveritarë, duke i akuzuar se janë të lidhur me fuqitë perëndimore dhe se zgjedhin një ideologji kaotike "revolucionesh me ngjyrë".

Qeveria në pushtet në Maqedoni është në favor të anëtarësimit në NATO dhe BE, por ajo ka qenë e hapur ndaj propozimeve për gazsjellësin Turkish Stream. Një qeveri e dobët, si dhe rritje e paqëndrueshmërisë në Maqedoni, po e pengon vendin që të bëhet një aleat i vendosur i Perëndimit, ose një partner i besueshëm i Ruisë.

Një sfidë më e gjerë rajonale

Përplasjet në Maqedoni risjellin hijet e ringjalljes së tensioneve etnike dhe dhunës

***Rusia po llogarit që të kalojë zgjatimin e gazsjellësit Turkish Stream nëpër Maqedoni, drejt Europës qendrore, por paqëndrueshmëria në vend rrezikon këta plane, në një kohë kur vendet e tjerë, që ndodhen përgjatë gjurmëve alternative të një projekti të tillë, nuk i mirëpresin propozimet e Ruisë***

kryenin sulme terroristë koha e zhvillimit të shumëkënd të besojë politikisht - një shpërqënvëmendjen nga programi ve nga ana e qeverisë. manovë, bashkë me e paligjshëm të informae dëmton edhe më tej verie, e cila edhe kështu min e popullit të saj. Në protestues u mblodhën donas, Shkup. Bisedimet morët, një ditë më vonë, promis mes qeverisë dhe pasojë pushteti i qeverisë

të kalojë zgjatimin e Stream nëpër Maqedoni, por paqëndrueshmëria plane, në një kohë kur hen përgjatë gjurmëve projekti të tillë, nuk i Ruisë. Qeveria bullgare nën trysninë e SHBA dhe

që udhëhiqet nga Rusia,

të politikave të saj.

Ministria kritikoi partitë opozitare dhe grupet joqeveritarë, duke i akuzuar se janë të lidhur me fuqitë perëndimore dhe se zgjedhin një ideologji kaotike "revolucionesh me ngjyrë".

Qeveria në pushtet në Maqedoni është në favor të anëtarësimit në NATO dhe BE, por ajo ka qenë e hapur ndaj propozimeve për gazsjellësin Turkish Stream. Një qeveri e dobët, si dhe rritje e paqëndrueshmërisë në Maqedoni, po e pengon vendin që të bëhet një aleat i vendosur i Perëndimit, ose një partner i besueshëm i Ruisë.

në Ballkan, ku kufijtë politikë nuk përkojnë me kufijtë etnikë. Ndonëse dhuna e kohëve të fundit nuk do të zgjerohet edhe në vendet fqinjë në të ardhmen e afërt, problemet e Maqedonisë janë një shqetësim për rajonin. Serbia e rriti nivelin e alarmit, ndërkohë që Bullgaria dërgoi trupa në kufi.

Që nga viti 1999, qeveritë perëndimore kanë punuar për të stabilizuar Kosovën dhe zonën përreth, përmes pranisë së paqeruajtësve dhe programeve të zhvillimit. Brukseli po i bën presion edhe Serbisë, që të normalizojë marrëdhëniet me Kosovën, si një parakusht për anëtarësimin në BE. Një rritje e mundshme e veprimeve militante përgjatë kufirit Maqedoni-Kosovë do të rrezikonte këtë stabilitet dhe do të dëmtonte përpjekjet e Perëndimit në rajon.

Në fund, pavarësisht se sa fuqi e jashtme politike investohet në Ballkan, sukcesi varet nga prania e qëndrueshme. Por dobëta. Në Bullvitin 2013 detyruan atëherë, vendi ka të dobëta e jetësrrëzuar prej moshme. Ndërkohë, paraliza politike ka të reformave ekonomojshme. Protesvitin 2014 nxorren mit politik boshnjak e vendit.

Paqëndrueshmëria mundëson fuqirrugëhyrje, duke përmes mbështetjes për qeveritë lokale. ballkanikë nuk i vendosmërisht nga shumë vende të shumë prej shteteve të arrijnë një shkallë gji ekuilibruese ballkanike të firmomike avantazhuese, me financiare dhe disa fuqi të huaja.

Rivalitetet gjeopolitike lokale në këtë rajon kanë qenë historikisht një kombinim shpërthyes, duke shkaktuar shumë konflikte si Lufta e Parë Botërore, si dhe shumë luftëra të armatosura në Ballkan. Sot, ka një konkurrencë me më shumë ngjyresa, teksa fuqitë perëndimore përdorin ndikimin ekonomik, bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, dhe mbështetjen politike për të cuar përpara objektivat e tyre në rajon.

Konflikti në Maqedoni - dhe potenciali që ai ka për të dëmtuar planet e Rusisë në rajon - mishëron problemet që fuqitë e mëdha ndeshin në Ballkan. Ndërkohë që Perëndimi, Rusia dhe Turqia janë të gatshëm të fusin kapitale në rajon për interesat e tyre, qeveritë e dobëta do të vazhdojnë lojën e ekuilibrit mes fuqive të huaja.

STRATFOR

***Paqëndrueshmëria e politikës në Ballkan i mundëson fuqive të huaja që të gjejnë rrugëhyrje, duke rritur influencën e tyre përmes mbështetjes financiare dhe politike për qeveritë lokale.***

***Por brishtësia e shteteve ballkanikë nuk i lejon ata që të anojnë vendosmërisht nga një fuqi e huaj. Ashtu si shumë vende të tjerë në skajet e Europës, shumë prej shteteve ballkanikë janë përpjekur të arrijnë një shkallë neutraliteti***

një qeverisje të fortë e të qeveritë e Ballkanit janë të gari, trazirat sociale në qeverinë të largohet. Që kaluar në për disa qeveri hkurtëra, të cilat janë marrëveshjeve të brendsnë Bosnje Hercegovinë, penguar vënien në zbatim mike dhe politike, aq të tat kundër korrupsionit në në pah paaftësinë e sistepër të adresuar problemet

e politikës në Ballkan i ve të huaja që të gjejnë rritur influencën e tyre financiare dhe politike Por brishtësia e shteteve lejon ata që të anojnë një fuqi e huaj. Ashtu si tjerë në skajet e Europës, ballkanikë janë përpjekur neutraliteti. Një strategnënkupton që qeveritë sin marrëveshje ekonomtë sigurojnë paketa ndihmbështetje politike nga

tikë dhe mosmarrëveshjet





# Kosovë e Bosnje, udhëtim në eksportuesit më të mëdhenj të xhihadistëve

VALENTINA COMINETTI

---

**I**SIS nuk mund të zgjidhte moment më të mirë se sa mbërritjen e Papës në Sarajevë, për të mbjellë pak terror me një filmim që kërcënon Ballkanin. Në fund të fundit, Al Hayat Media Center (mjeti kryesor i komunikimit dhe mediat e reja të Shtetit Islamik) është i njohur për profesionalizmin dhe koherencën sa i përket agjendës mediatike.

Kështu në 5 qershor, kanalet e informimit të të gjithë botës shpallën se militantë boshnjakë, shqiptarë dhe kosovarë u bëjnë thirrje bashkëkombësve të tyre dhe vëllezërve të besimit që të “marrin hak për poshtërimet e pësuar nga myslimanët në Kosovë, në Shqipëri dhe në Maqedoni”, për të luftuar kundër “nënshtrimin nga ana e të krishterëve”. “Do t’ju mbysim”, dhe “do t’ju vrasim, do të vijmë me rripat me eksplozivë, dhe kjo do të ndodhë shumë shpejt”.

Perceptimi i opinionit publik ballkanik për këtë filmim është i ndryshëm nga ai europian dhe amerikan. Më pak ankth; aq sa mediat boshnjake nuk u ndalën

shumë tek kjo temë. Denis Hadzovic, drejtor i Qendrës së Studimeve për Sigurinë në Sarajevë, na shpjegon se tashmë ka hsumë kohë që në këto anë dëgjojen mesazhe që nxisin për xhihad në Ballkan, e si pasojë përhapja e këtij filmimi të fundit nuk duhet të ketë shumë efekt në rekrutimin e xhihadistëve të zonës. Ajo që shqetëson, në fakt, është që ISIS po përmirëson me shpejtësi aftësinë e vet për të përhapur informacione në internet dhe që autoritetet kompetente nuk janë në gjendje t'i frenojnë.

Por të shumtë janë ata që mendojnë se institucionet nuk dinë të përballojnë edhe probleme të tjerë. Mjafton të mendosh që gjatë javëve të fundit, vendet e Ballkanit janë tronditur nga sulme që kanë nxjerrë në pah të gjithë dobësinë e tyre në përballimin të vetëm të rrezikut terrorist, që qëndron mbi kokat e tyre. Në 21 prill, 40 persona të armatosur, të organizuar në një komando që i përket, sipas autoriteteve maqedonase, asaj që ka mbetur nga UCK, pushtuan për disa orë ndërtesën e policisë në një qytet në veri të Maqedonisë. Më pas u larguan dhe u zhdukën para mbërritjes së përforcimeve nga Shkupi, që megjithatë nuk u shfaqën të aftë në ndërhyrje.

Pak ditë më vonë, në 28 prill, një i ri vehabit sulmoi zyrën e policisë në Zvornik (Republika Srpska në Bosnje Hercegovinë); bilanci i sulmit, vdekja e atentatorit dhe një agjenti. Përsëri në 9 maj në Maqedoni, në kufi me Serbinë, qyteza e Kumanovës u bë

së 50 anëtarëve të policë dhe plagosën edhe civilë, në një suar. Më pas, në 5 rregjistruar që kërr-e Ballkanit.

Sipas të dhënave të Studime të Sigurisë janë dy eksportue-luftëtarëve të huaj, banorëve, me res-luftëtarë jashtë ven-forcimit të masa-miratimit të ligjeve ata që vendosin të luftërat e të tjerëve. rendit boshnjake është përbërja e tyre burojnë. Në Bosnje, derata kroato-mys-Srpska) veprojnë gjithmonë hyjnë të bashkërenduar. Republika Srpska, Zvornikut, e mendoj operacionin Ruben, 32 personave dhe

municioneve dhe materialeve të propagandës, që bënin të mendohej për lidhje me celulatat e terrorizmit islamik. Dhe e ka bërë pa u koordinuar me policinë boshnjake. “Ne e njohim mirë problemin, por kemi fuqinë t’i kundërvihemi vetëm në territorin ku kemi kompetencë”, thotë Gojko Vasic, drejtor i policisë serbe. “Do të ishte e nevojshme të koordinoheshim për të patur një pamje të plotë, por kjo gjë është e mundur vetëm me një ndihmë nga komuniteti ndërkombëtar, sepse këtu ka shumë fërkime politike”.

***Sipas të dhënave të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, Kosova dhe Bosnja janë dy eksportuesit kryesorë botërore të luftëtarëve të huaj, në raport me numrin e banorëve, me respektivisht 232 dhe 330 luftëtarë jashtë vendit. Dhe kjo pavarësisht forcimit të masave antiterrorizëm dhe miratimit të ligjeve që ndëshkojnë rëndë ata që vendosin të shkojnë të luftojnë në luftërat e të tjerëve***

dëshmitare e përplasjes UCK, të cilët vranë 837. Këtë herë u përfshinë numër ende të pasaktë-qershor, erdhi mesazhi i cënon të gjithë të pafatë

Qendrës Kosovare për risë, Kosova dhe Bosnja sit kryesorë botërore të në raport me numrin e pektivisht 232 dhe 330 dit. Dhe kjo pavarësisht ve antiterrorizëm dhe që ndëshkojnë rëndë shkojnë të luftojnë në Problemi i forcave të dhe kosovare, duket se etnike dhe tensionet që e ndarë në dy njësi (Felimane dhe Republika dy trupa policore që jo në veprim në mënyrë Mjafton të mendosh që në vijim të atentatit të të arsyeshme të niste i cili coi në arrestimin e sekuestrimin e armëve,

Na e konfirmon Predrag Čeranić, profesor në Universitetin e Banja Lukas dhe kreu i shërbimit të fshehtë boshnjak gjatë luftës. “Shkëmbimi i informacioneve mes agjencive të sigurisë ballkanike është shpesh i pamjaftueshëm”. Pjesa boshnjake i sheh në mënyrë krejt të ndryshme, aq sa në vijim të operacionit të sipërpërmendur Ruben, nisën polemikat nga ana e komunitetit të myslimanëve të Bosnjes, që akuzojnë serbët se duan të shfrytëzojnë problemin e terrorizmit për të organizuar një spastrim të ri etnik. Madje Bakir Izetbegovic, eksponent mysliman i Presidencës së Bosnje Hercegovinës, po u paguan avoketërit 32 të arrestuarve.

“Gjithcka në këtë vend instrumentalizohet politikisht dhe argumenti i xhihadit është vecanërisht i prirur të ketë interpretime të ndryshme”, thotë ambasadori italian në Bosnje, Ruggero Corrias. “Nga një anë është prirja për ta zvogëluar fenomenin, nga ana tjetër për ta fryrë. Problemi ekziston në të gjithë Europën, dhe Bosnja, me kufijtë e pasigurtë dhe ekuilibrat etnikë, fetarë dh epolitikë të dobët, nuk është përjashtim. Ne po punojmë mirë, jemi koordinues të programit kundër kriminalitetit, në të cilin janë investuar 5 milionë Euro”.

Shërbimi i Policisë së Kosovës ka një përbërje shumëetnike që pasqyron pjesët e popullsisë aktuale: shqiptarët dhe serbët janë shumica (me respektivisht 4759 dhe 530 agjentë), por ka edhe boshnjakë, kerkezë, kroatë, egjiptianë, goranë, maqedonë, malazezë, romë dhe turq. Në janar 2014, falë vënies në zbatim të marrëveshjes së Brukselit, policët serbë u integruan në Policinë Kosovare, por i përgjigjen gjithësesi një komandë të ndryshme nga ajo e kolegëve të tyre shqiptarë. Policia kosovare është më e reja e policive të botës: stërvitet e para nisën në shtator 1999 nën mbikëqyrjen e KFOR dhe Njësisë së Specializuar Shumëkombëshe. Policia e Kosovës është rritur shpejt dhe nga viti 2008 është reaguesja e parë e sigurisë në Kosovë, e mbikëqyrrur nga Eulex dhe Kfor. Gjenerali Salvatore Farina, në komandë të KFOR nga 6 shtatori 2013 deri në 4 shtator 2014 pohonte në prill të vitit që kaloi, se “policia kosovare po punon mirë, por ka ende probleme sa i përket menaxhimit të sigurisë”. Pra një tërheqje e menjëhershme e KFOR nuk do të ishte e këshillueshme sepse “qetësia është vetëm në dukje”.

“Duhet të punojmë të gjithë bashkë, të përfshihet Europa, sepse ky nuk është problem vetëm i Ballkanit”, thotë Gojko Vasic, drejtor i policisë së Republika Srpska. E konfirmon eksperti Predrag Čeranić: “Komuniteti ndërkombëtar duhet të vërë në lëvizje një makineri më efikase për të luftuar xhihadizmin. Nuk mund të kufizohemi me forcimin e bashkëpunimeve dypalëshe mes shteteve. Kushdo që ka një minimum aftësisë është i vetëdijshëm se, nëse bie Damasku, xhihadi do të vijë në Ballkan, për t’u përhapur më pas në gjithë Europën”.

**Il Giornale**



# Tërheqja e SHBA në arenën globale, “trokitje” në luftë

NGA VICTOR DAVIS HANSON  
*HISTORIAN*

**P**ër një farë kohe, bisedimet, lëshimet dhe pajtimi, funksionojnë në vonimin e luftërave. Por më në fund, kombet zgjohen, kuptojnë gabimet e tyre, riarmatosen dhe përballen me armiqtë. Atëherë, situata bëhet e rrezikshme. Agresorët e tronditur, thjesht nuk mundën ta besojnë, se objektivi i tyre bëhet papritmas serioz dhe i gatshëm për t’u kundërpërgjigjur. Zakonisht, të fortët nxisin me mendjelehtësi agresionin, dhe kësioj shpërthen lufta. Ishte çmenduri e Gjermanisë naziste dhe partnerëve të saj të Boshtit, madje edhe ta imagjinonin se mund të mposhtnin treshen e aleatëve, Britanisë Perandorake, Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara. Por pse të mos e provonin? Hitleri, llogariti se për një dekadë Amerika kishte qenë e paarmatosur dhe e izoluar. Britania në mënyrë të përsëritur, ishte paqtuar me Rajhun e Tretë. Sovjetikët, fillimisht bashkëpunuan me Hitlerin. Ky i fundit, nuk ndeshi asnjë kundërshtim pas rimilitarizimit të vendit. Ai e aneksoi Austrinë, pa u ndëshkuar.

Gllabëroi Çekoslllovakinë, pa asnjë kundërshti. Pse të mos habitej Hitleri në vitin 1939, kur Britania dhe Franca më në fund i shpallën luftë, pas pushtimit të Polonisë? Gjashtë vitet e luftës, dhe rreth 60 milionë të vdekurit që pasuan, ri-vendosën atë që duhet të kishte qenë një fakti i qartë, se demokracitë nuk do të kryenin vetëvrasje.

Në vitin 1979, administrata e Xhimi Karterit, kishte shkurtuar në mënyrë drastike buxhetin e mbrojtjes. Karter, premtoi se do të kishte të drejtat e njeriut, si parim bazë të politikës së jashtme amerikane. Ato fjalë, iu dukën madhështor amerikanëve pas Vietnamit - dhe akoma më të mëdha armiqve të Amerikës. Pastaj Irani u shemb plotësisht nga përbrenda. Ambasada amerikane në Teheran u sulmua. Diplomatat u morën peng. Terrorizmi i radikalizmit islamik, u përhap në të gjithë Lindjen e Mesme. Kryengritja komuniste, pasoi në të gjithë Amerikën Qëndrore. Bashkimi Sovjetik pushtoi Afganistanin. Kina ndërhyri në luftën e Vietnamit.

Diktatorë të tillë si Leonid Brezhnjevi i Bashkimit Sovjetik dhe Ajatollah Khomeini i Iranit, supozuan, se Karteri nuk ishte më i gatshëm të mbronte rendin e amerikan të pas-

ata menduan se amerikan, ishte kundërpërgjigjur, ta bënte një gjë të Pastaj, Ronald Reganin 1980, mbi premtimin e fuqinë amerikane. ashtu edhe armiq të nga botëkuptimi i se tregjet e lira ishin zmi, se demokracia diktaturës, dhe se në Perëndimi do të fitë humbiste. Media e huaj, e nxitës të rritjes së duke rigarantuar iu vënë pas terroristarake. Në vikarikaturohej edhe – jo si burr i shtetit, njohur për rivendosdhe stabilitetit globalë dha për rrëzimin e sovjetik.

Barak Obama, ngjashëm me Karterin, erdhi në detyrë duke premtuar një divorc të prerë, nga praktikat e shkuara të politikës së jashtme të SHBA-së. Publiku ishte hapur për këtë, pas luftërave të kushtueshme në Afganistan dhe Irak, dhe krizës së fundit financiare në Wall Street.

Trupat u tërhoqën nga Afganistani në afatet e para- shpallura. Njëfarë qetësie e momentit, e mashtroi Obamën, që me padurim i tërhoqi të gjithë paqeruajtësit amerikanë. Një terren i ri për islamin radikal, u kultivua deri në grotesk. Vëllazëria Myslimane, u ftua në fjalimin e Obamës në Kajro, ku deklaroi se Perëndimi i ka një borxh kulturor ndaj Islamit për çdo gjë, nga Rilindja tek Iluminizmi.

Terma si islami radikal, xhihad dhe terrorizmi islamik u përjashtuan nga fjalori zyrtar amerikan, duke u zëvendësuar me një mori eufemizmash pa kuptim. Në një turne simbolik, Obama kërkoi ndjesë për sjelljen e shkuar të SHBA-së në Lindjen

***Diktatorë të tillë si Leonid Brezhnjevi i Bashkimit Sovjetik dhe Ajatollah Khomeini i Iranit, supozuan, se Karteri nuk ishte më i gatshëm të mbronte rendin e amerikan të pasluftës. Apo ndoshta, ata menduan se presidenti i papërvojë amerikan, ishte shumë i dobët për t'iu kundërpërgjigjur, edhe nëse do dëshironte ta bënte një gjë të tillë***

luftës. Apo ndoshta, presidenti i papërvojë shumë i dobët për t'iu edhe nëse do dëshironte tillë.

e mundi Karterin në vitimin për të restauruar Në fillim, si miqtë e Amerikës, u tmerruan thjeshtëzuar i Reganit, më të mira se komunishte superiore ndaj një luftë të mundshme, tonte dhe pjesa tjetër do

denoncoi Reganin si një shpenzimeve ushtarake, aleatët e Amerikës, dhe ristëve përmes forcës tet 1981- 1983, Regan në SHBA si një kauboj që më vonë do të ishte i jen e prestigjit të SHBA bal, si dhe për ndihmën komunizmit perandorak

e Mesme dhe Azi. Ai iu përkul si sheikëve teokratë, ashtu edhe monarkëve aziatikë.

Buxheti i mbrojtjes, u pakësua ndjeshëm. Rivendosja e raporteve të mira me Rusinë e Vladimir Putinit, donte të thoshte se ishte administrata e Presidentit Bush, dhe jo agresioni i mëhershëm i Putinit në Gjeorgji apo edhe kërcënimet ndaj Krimesë, ato që shkaktuan ftohje mes Moskës dhe Uashingtonit.

Kaos i parashikueshëm pasoi, ndërsa SHBA-ja u bë një vëzhguese e jashtme e rrokopujës. Shteti Islamik, u shfaq për të mbushur boshllëkun në Irak. Siria u shemb plotësisht nga përbrenda. Kështu ndodhi edhe me pjesën dërrmuese të Afrikës Veriore. Irani ka dërguar agjentë, mercenarë dhe forca speciale në Irak, Siri dhe Jemen, ashtu siç edhe ushtron presion, se do ta ndërtojë armën bërthamore. Kina ka shtuar rastet e shkeljet së ujërave, dhe hapësirës ajrore të aleatëve tradicionalë aziatike të Amerikës. Putin bëri të njëjtën gjë në Evropën Veriore dhe Lindore. Deri më sot, armiqtë e Amerikës kanë krijuar kaos dhe e përkufizuan atë, si normaliteti i ri. Presidenti i ardhshëm, do të përballet me një dilemë të tmerrshme. Për të rivendosur rendin, ai ose ajo, do të duhet të bindë aleatët tanë se ne jemi të riangazhuar për sigurinë e tyre.

Çdo vijë e kuqe, do të duhet të zbatohet. Agresorë të tilla si Rusia, Kina, Irani dhe Shteti Islamik, duhet të paralajmërohen të ulin armët dhe tërhiqen, ose do të përballen me kundërveprimin e fortë të koalicionit të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara. Ashtu si rikthimi në normalitet, që Regani i bëri politikës së jashtme amerikane, u cilësua radikal pas viteve të Karterit, edhe administrata e ardhshme do të etiketohet si provokative, pas tërheqjen së Obamës nga skena botërore. Politika e jashtme e Obamës, nuk mund të vazhdojë shumë më gjatë kështu, pa provokuar edhe më shumë kaos, apo një luftë të madhe. Megjithatë, korrigjimi i këtij kursi, do të jetë po aq i rrezikshëm. Braktisja e rolit të tigrit global është e rrezikshme, por rrimarrja e atij atributi, do të duket edhe më i frikshëm.

/ “Hoover Institute”/

**Shënim: Victor Davis Hanson është historian në Institutin Hoover dhe Universitetin Stanford**



# Pse Turqia votoi kundër autoritarizmit

NGA DAVID IGNATIUS

**M**arshimi i autoritarizmit në mbarë botën, ka patur emra të ndryshëm gjatë dekadës së shkuar: “Neo- otomanizëm”, “Putinizëm”, “Konsensusi i Pekinit”. Premisa e përbashkët ka qenë se sistemet demokratike të brishta, nuk ishin në përputhje me sundimtarët e fortë, që mund të impononin zgjidhje nga lart-poshtë.

Ideja e një despoti efektiv, mori një goditje të fortë të dielën e shkuar, në zgjedhjet parlamentare në Turqi. Me një pjesëmarrje prej më shumë se 86 përqind, votuesit ia mohuan Presidentit Rexhep Taip Erdogan shumicën që ai donte, për të ndryshuar kushtetutën dhe dhënë vetes më shumë pushtet ekzekutiv.

Rezultati pohoi fuqinë stabilizuese të demokracisë, dhe mençurinë e një elektorati të informuar. Komentatorët turq ishin të ngazëllyer. “Pax Erdogan mori fund”,- tha për “New York Times” Ozgur Unluhisarcikli, përfaqësues në Ankara i “German Marshall Fund”, duke shtuar se “Turqia ka dëshmuar se është një demokraci e vetë- korrigjueshme”. Bulent Aliriza i Qendrës për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare, i krahasoi zgjedhjet me “një shpërthim bërthamor në politikën turke”.

Po pse votuesit turq e refuzuan autoritarizmin, në një kohë kur sharmi i Erdogan

duket ende i fortë në vendet e tjera? Përgjigja me siguri, fillon me forcën relative të institucioneve politike në Turqi. Demokracia laike atje është thajse një shekull e vjetër: Ajo i ka mbijetuar konflikteve të nxehta, luftërave të ftohta, grushteve ushtarake të shtetit si dhe ekstremistëve fetarë.

Turqit e dinë se kanë diçka për të humbur, në rast se sistemi i tyre ndryshon.

Turqia gjithashtu ka një kulturë qytetare, ku mund të mbështeten institucionet demokratike. Ajo ka ndërkaq edhe një ekonomi të gjallëruar të tregut të lirë, shtyp të lirë, ushtri të forte, dhe një sistem të pavarur gjyqësor. Këto ishin pjesët e shoqërisë turke, që Erdogan po përpiquej t'i frikësonte apo shtypte, në tentativën e tij për të fituar një pushtet më të madh.

Gazetarët, gjeneralët dhe gjyqtarët, nuk mund të luftojnë secili më vete në mënyrë efektive, por votuesit së bashku mundën ta bëjnë këtë. Si për ironi, vetë Erdogan ka ndihmuar në nxitjen e aktivizmit kurd, që ishte një faktor përcaktues në zgjedhjet e së dielës.

Partisë për Drejtësi zgjedhësit kurdë, të drejta - dhe madhë për një fare kohe, njohur si Partia e ose PKK.

Por të dielën, mjekurdëve, rezultoi Popullore Demokratik lideri karizmatik ka fituar më shumë duke u bërë qartazi me orientim kurd në Kjo shfaqje e plurturke, mund të jetë edhe kundërshtimi, pushtetin e tij drejt Zgjedhjet turke kanë shkak se ato sfiduan dukej si një rritje fortë nacionalist dhe Përkrahësit e të as-i Pekinit”, argu-e madhe e modelit noi; pushteti i centë arrijë rezultate që ishin të pamundura në demokracinë tejet kaotike dhe të tipit nga poshtë-lart.

Këta anti-demokratë, ishin të nxitur (dhe kritikët u zhvlerësuan) nga suksesi i Presidentit kinez Xi Jinping, i cili e këto kohë e portreitizon veten si “Xhaxhai Xi” ose “Babi i Madh Xi”. Vladimir Putin i Rusisë, është një tjetër avatar i autoritarizmit modern. Ajo çka është shqetësuese në lidhje me Putinin, është se regjimi i tij i korruptuar dhe agresiv, mbetet jashtëzakonisht popullor tek populli rus.

Organizata joqeveritare ruse, e specializuar në kryerjen e sondazheve “Levada Center”, njoftoi kohët e fundit se popullariteti i shefit të Kremlinit është rreth 86 përqind, pavarësisht sanksioneve, një ekonomie në rënie dhe shtypjen e zërave kundër.

Ndërkohë vlerësimi mbi presidentin amerikan Obama, qëndron në rreth 45 përqind. Cilësitë e arsyes dhe përmbajtjes, që ndoshta të ndihmojnë në përcaktimin e Obamës si një lider demokratik janë marrë në rastin e tij, si një shenjë dobësie. Putin, duket se po i përgjigjet një dëshirë të zjarrte popullore ruse, për madhësi

***Gazetarët, gjeneralët dhe gjyqtarët, nuk mund të luftojnë secili më vete në mënyrë efektive, por votuesit së bashku mundën ta bëjnë këtë. Si për ironi, vetë Erdogan ka ndihmuar në nxitjen e aktivizmit kurd, që ishte një faktor përcaktues në zgjedhjet e së dielës. Në këtë kuadër, kryetari i Partisë për Drejtësi dhe Zhvillim, ka joshur zgjedhësit kurdë***

Në këtë kuadër, kryetari i dhe Zhvillim, ka joshur duke iu ofruar më shumë je edhe duke bërë paqe, me grupin ekstremist të Punëtorëve të Kurdistanit,

ti për vetë-shprehjen e të jetë Partia liberale tike HDP, e kryesuar nga Selahatin Demirtash. Ajo se 13 përqind të votave, partia e parë parlamentare historinë e Turqisë. ralizmit në jetën politike po aq e rëndësishme sa që Erdogan të zgjeronte funksioneve ekzekutive. një rëndësi globale, për atë që deri kohët e fundit e paepur e një njeriu të parties së tij autoritare. htuquajturit “Konsensusi mentojnë se përparësia kinez, ishte se ai funksio-tralizuar shtetëror, mund



dhe perandori. Por fjalë të ngjashme u përdorën vetëm disa muaj më pare, për të përshkruar sharmin e Erdogan si një “neo-otoman”, një lider turk me pushtet (dhe pallatet) e një sulltani.

Madje edhe rezistenca popullore, që filloi të shfaqet tek protestat në Gezi Park të Stambollit në vitin 2013, e vunë Erdoganin nën presion. Nuk ishte e qartë, nëse ai kishte tejkalluar masën deri të dielën. Fareed Zakaria ka shkruar gjatë dekadës së kaluar, në lidhje me ngritjen e asaj që ai e quan “demokraci mendjengushtë” - fuqinë në rritje të udhëheqësve të tillë si Erdogan, Xi dhe Putin, të cilët qeverisin me një mbulesë të legjitimitetit popullor, por kanë në bazë kontrollin shtetëror. Ju mund të shtoni në atë listë edhe liderin e fortë, të zgjedhur përmes një votë të madhe popullore në Egjipt, presidentin Abdel Fatah Al-Sisi. Amerikanët janë shumë të shpejtë, kur e përcaktojnë një demokraci, bazuar tek cilësia e zgjedhjeve. Ajo çfarë prodhoi rezultati me të vërtetë demokratik i së dielës në Turqi, ishte diçka më e thellë sesa fakti që një numër i madh njerëzish morrën pjesë në votime. Erdogan nuk arriti të përmbushë synimet e tij, për shkak se ai e sfidoi kulturën e kontrollit dhe të balancës, si dhe institucionet që i japin demokracisë turke elasticitetin e saj.

**The Washington Post**



## Pasioni, dhe jo “Power-Point”-i i çojnë përpara kauzat morale në politikë

*Në një botë shumëkanalëshe, nuk mund të presësh që publiku të vijë tek ti. Kjo do të thotë se duhet të mendosh dhe të vepros, si një njeri në detyrë dhe një sfidant në të njëjtën kohë. Duhet të kombinosh “fuqinë e zjarrit” të një aktori të afirmuar, me*

NGA JIM MURPHY

---

**M**und të mësosh shumë gjëra për vendin tënd, kur realizon një tur në 100 qytete për 100 ditë. Në muajt e fundit para referendimit për pavarësinë e Skocisë vitin që kaloi, unë bëra pikërisht këtë gjë, duke e parashtruar argumentin tim në mbështetje të Mbretërisë së Bashkuar në takime të hapur, nëpër qoshe rrugësh dhe sheshe qytetesh, apo qendrash tregtare. Mësova për bukuritë e Skocisë dhe çuditë e saj. Ishte një burrë që sa nuk mu hodh përsipër, dhe ulëriti “Tradhëtar”, mu tek veshi. Më tha se quhej William Wallace; unë kisha dyshimet e mia për vërtetësinë e kësaj. Takova një djalë, qeni i të cilit kishte të shkruajtur fjalën “Liri” mbi kurriz. Kur i mendoj sot, në retrospektivë, shumë gjëra ishin për të qeshur. Herë pas here, energjia nga nacionalistët

ishte e pakëndshme. Por, unë mësova të vërtetën e asaj fjale të urtë që e përmendnin shpesh radikalët e viteve 1960: demokracia është në rrugë.

Kam menduar për referendumin mbi pavarësinë, si dhe fitoren e ngushtë të unionistëve, teksa përgatitemi për të votuar mbi anëtarësinë e Britanisë në BE. Janë katër mësimet të qartë për ata prej nesh, që besojnë se Britania ka nevojë të qëndrojë në BE - dhe nevoja që biznesi të luajë një rol qendror dhe të flasë me zë të lartë dhe sa më herët, është në qendër të tyre.

Mësimi i parë është një që unë e mësova në rrugë: fushatat e suksesshme kanë nevojë për një politikë angazhimi. Për të mposhtur populizmin në ngjitje të anti-europianëve, ne duhet të mendojmë dhe të luftojmë si ata - ndonëse fushëbeteja është transformuar prej Twitterit dhe Facebookut. Smartphone - kompjuteri në xhep i më shumë se 60% të të rriturve - po shndërrohet në një burim dominues lajmesh. Grupet e fokusit zbulojnë një përdorim të rëndësishëm të aplikacioneve të lajmeve dhe opinionëve të fortë që shfaqen në ta. Një votues i pavendosur u zemërua aq shumë nga një lajm, që e pa si të anshëm nga ana e BBC, sa që e fshiu fare aplikacionin nga celulari dhe e zëvendësoi me Al Jazeeraan.

Në Skoci, debati dhe cioneve vazhdoi kudo: netike dhe në punë e dhe në portat e shkondrejta e votimit iu dha debatua edhe në klasa. nalëshe, nuk mund të të vijë tek ti. Kjo do mendosh dhe të vedetyrë dhe një sfidant Duhet të kombinosh një aktori të afirmuar, rishtari. Mbi të gjitha, mendon, por edhe që Mësimi i dytë është ashtu sikurse dhe për tetë në politikë është modernë, në botën PowerPoint, janë shtuar kur përballen me në lëvizje zemrat dhe në Mbretërinë e Basprej fushatave më të kohërave, ku njerëzit larg. Një mungesë e vërehej herë pas here së bashku”, fushata pavarësisë së Sko-

gjithë faktet, për problemet që do të haste një Skoci e pavarur, numrin e vendeve të punës që viheshin në rrezik dhe kostot e shkëputjes. Por, duke iu përmbajtur fakteve, fushata e “JO”-së linte një zbrazëti të madhe në zemrën e saj: quajeni krenari, dashuri apo pasion, por ai që mungonte, ishte një emocion. Ne duhej t’u paraqisnim votuesve një formë alternative optimizmi patriotik; ndjesinë që nuk ishim thjeshtë njerëz që thoshim jo, por që besonim në mënyrë të palëkundur në një kauzë.

I njëjti risk qëndron në mënyrën si po formësohet debati për BE. Shpesh herë duket sikur përqëndrohet vetëm në përfitimet e tregtisë me fqinjët europianë, sikur zgjedhja është vetëm nëse do të qëndrojmë brenda apo jashtë bllokut të

***Mësimi i parë është një që unë e mësova në rrugë: fushatat e suksesshme kanë nevojë për një politikë angazhimi. Për të mposhtur populizmin në ngjitje të anti-europianëve, ne duhet të mendojmë dhe të luftojmë si ata - ndonëse fushëbeteja është transformuar prej Twitterit dhe Facebookut. Smartphone - kompjuteri në xhep i më shumë se 60% të të rriturve - po shndërrohet në një burim dominues lajmesh***

shkëmbimi i informacionë hapësirën kibernetë shtëpi, në pub- e llave. Dhe, ndërsa e edhe 16-vjeçarëve, u Në një botë shumëkapsësesh që publiku të thotë se duhet të prosh, si një njeri në në të njëjtën kohë. “fuqinë e zjarrit” të me shkathtësinë e një trego që jo vetëm “të bëhet vonë”. nevoja për pasion, fakte. Pasioni i vëri rrallë. Politikanët e prezantimeve në pesh herë të çorientnevojën për të vënë mendjet. Në zgjedhjet hkuar, kemi parë një pastruara të të gjitha e vërtetë janë mbajtur ngjashme angazhimi në punën e “Më mirë ndërpartiake kundër cisë. Ne kishim të

tregtisë. Kjo është një pikëpamje minimaliste e asaj që është në lojë. Dhe është një debat që proeuropianët nuk mund ta fitojnë asnjëherë, përderisa është teknik, dhe jo emocional.

Ne, kampi pro BE, duhet të vëmë theksin në faktin që Europa nuk është thjeshtë një zonë e tregtisë së lirë, por edhe përgjegjëse për një prej triumfeve të mëdhenj moralë të kohës sonë: krijimin e demokracisë dhe sundimit të ligjit në jug dhe në lindje të Europës. Gjatë periudhës së anëtarësimit britanik, BE ka pranuar dy valë anëtarësh të rinj dhe i ka mbështetur në udhëtimin nga diktatura, në demokraci. Në vitet 1980 ishte Spanja, Portugalia dhe Greqia. Pas rënies së Murit të Berlinit në vitin 1989, ishin ish-anëtarë të bllokut komunist të Lindjes.

Unë kam qenë dëshmitar i vlerës së fuqisë së butë të Europës, siministër për Europën në vitet 2007-2008. Vende të tjerë aspirantë e modifikuan sjelljen e tyre, në shpresën për një marrëdhënie më të ngushtë me një treg të përbashkët, i cili është edhe një union i të drejtave të njeriut.

Pra, ideali european është pikërisht i tillë: një ideal, një vizion. Ajo që ne bëjmë si një forcë për të përballuar ndryshimet klimatike, përhapur të drejtat e njeriut, mbështetur qeverisjen e mirë dhe luftuar korrupsionin në vendet në zhvillim - të gjithë këto duhet të jenë në ballë të fushatës për të qëndruar në Europë.

Dhe këtu vjen mësimi im i tretë: rëndësia e biznesit. Një rrezik për ata që mbështesnin fushatën e "JO"-së në Skoci, ishte se kompanitë përpiqeshin të qëndronin larg fushatës. Nuk kishte dyshim se shumica prej tyre ndanin mendimin se do të ishte rrezik i madh largimi nga unioni ekonomik, monetar dhe tregtar që është Mbretëria e Bashkuar. Por disa preferonin një jetë të qetë; të tjerë mendonin që referendumi mund të fitohej edhe pa ta.

Kjo krijoi probleme. Teksa deklaratat e vonuara nga ana e udhëheqësve të biznesit u injoruar si ndjellafrikëse, politikanëve iu desh të marrin një pjesë të madhe të barrës së debatit. Nevojitet një pluralitet zërash, që në fillim; kjo u jep më shumë besueshmëri argumentave. Udhëheqësit e biznesit do të dëgjohen më seriozisht kur flasin për ekonominë. Dhe nuk duhet të jenë vetëm kompanitë më të mëdha, apo ato që janë më të ekspozuara ndaj riskut të një Brexit. Ata që kanë marka të besuara duhet të flasin - sidomos markat për të rinjtë, pasi të rinjtë janë kryesisht proeuropianë.

Në fund, le të kuptojmë se ky votim nuk do t'i japë fund një herë e mirë debatit european për një brez. Ky është një mësim i kollajtë dhe i hershëm nga Skocia. Për kundërshtarët e anëtarësimit në BE, fushata për referendumin e ardhshëm fillon kur zyrtarët që kthehen bëjnë deklaratën e tyre - duke supozuar që ne votojmë për të qëndruar. Kështu është politika.

Eshtë detyra jonë ta bëjmë çdo vit, çështje patriotike, të qënurit pjesë e BE. Fakti që e kemi neglizhuar këtë na ka sjellë deri këtu. Nuk duhet ta përsërisim gabimin. Nëse e bëjmë, do të gjendemi sërish në këtë pikë. Jim Murphy është udhëheqës i Laburistëve skocezë dhe ka qenë ministër për Europën si dhe Sekretar Shteti për Skocinë

**FT**



# Ja ku qëndron problemi me aleatët e SHBA

NGA RICHARD SOKOLSKY DHE JEREMY SHAPIRO\*  
"BROOKINGS INSTITUTE"

---

**A**leatët kanë qenë prej kohësh në qendër të strategjisë së SHBA-së mbi sigurinë kombëtare, dhe kjo ka qenë e theksuar sidomos gjatë presidencës Obama. "Ne duhet" – deklaroi presidenti Obama në Maj 2014, "të mobilizojmë aleatët dhe partnerët tanë, për të ndërmarrë veprime kolektive. ... Duhet të bashkëpunojmë me të tjerët, për shkak se veprimi kolektiv në këto rrethana, ka më shumë gjasa të ketë sukses, më shumë të ngjarë të jetë i qëndrueshëm, dhe më pak mundësi për të çuar në gabime të kushtueshme".

Ky fokus mbi aleatët, në një botë në të cilën pushteti është i përhapur dhe krizat janë shumëfishuar, është një politikë e mirë. Aleatët e pakësojnë barrën financiare të angazhimit ushtarak të Shteteve të Bashkuara, si dhe i japin legjitimitet më të madh aksioneve të Uashingtonit. Për më tepër, Shtetet e Bashkuara e dinë se aleatët dhe partnerët më besnikë, kanë shpesh ide më të mira mbi mënyrën sesi duhet të trajtohet një krizë, si dhe një avantazh krahasues në zbatimin e tyre, sidomos kur është fjala për të kuptuar dinamikat lokale.

Për këto arsye, administrata e Obamës, sikurse administratat e mëparshme, ka shpenzuar shumë kapital diplomatik, për të lidhur aleanca zyrtare dhe jozyrtare, dhe shpenzuar miliarda dollarë, sipas zhargonit të Pentagonit për “ndërtimin e kapaciteteve të partnerëve”. Por kjo praktikë, nuk duket se po funksionon edhe aq mirë.

Aleatët amerikanë në mbarë botën, duket se janë gjithnjë e më pak të gatshëm dhe të aftë, për të kontribuar në qëllimet e përbashkëta. Shumica e aleatëve evropianë, janë tërhequr në vetevete, duke pakësuar shpenzimet e mbrojtjes, edhe pse Rusia po bëhet përherë e më agresive. Nga ana tjetër, aleatët aziatikë, duken më të përqëndruar në kritikën ndaj papërshtatshmërisë së ribalancimit të administratës amerikane në rajonin e Azi-Paqësorit, sesa në formimin e institucioneve racionale të sigurisë, që mund t’i përgjigjen në mënyrë të efektshme rritjes së Kinës. Më e keqja është se aleatët e SHBA-së në Lindjen e Mesme, janë kryesisht një koleksion laraman dhe kronikisht të bashkë-varur petro-shtetesh dhe entitetesh korruptive në buzë të kaosit. Pra, çfarë shkoi keq? Pse përpjekja për të fuqizuar aleatët e Amerikës, ka qenë kaq pak produktive?

Paradoksi i varësisë

Paradoksalisht, përpjekjet e SHBA-së për ndërtimin e kapaciteteve, i kanë dobësuar, në vend se të fuqizonin aleatët tanë, veçanërisht shtetet evropiane dhe arabe, duke krijuar kështu një

deri kohët e fundit, e Administrata e saj, u bëri thirrje këtyre kapacitetet e nevojsh-të njëjtën kohë i pa-e fundit do t’i mbrojë Qeveria amerikane, problem, duke kërkuar rezultate, për zhvilliluftarak.

Në vend se ta lidhë për shtetet arabe, provave të caktuara të mit, logjistikës, komandkontrollit, Uashingtoni duke e trajtuar shit-të madhe thjesht si Dhe duke mos ofruar pengesa për performancën bashkuara kanë shkelur japin fund aleancave që përgjegjësi. Së fundmi, shpesh synime tepër dore një mësim të th-korruptuara, represive mentuara, të gjitha pa-e botës, nuk mund të blejnë vullnetin për të luftuar, profesionalizmin ushtarak, udhëheqjen dhe moralin.

Në mënyrë që gjërat të qëndrojnë njëloj, gjërat do të duhet të ndryshojnë. Të paktën që nga viti 2011, administrata Obama është përfshirë në përpjekje mjaft të fshehta, për t’i ndryshuar këto dinamika. Në Libi, Mali, dhe Jemen, SHBA ka kërkuar të heqë “rrjetën” e vet të sigurisë, duke të inkurajuar edhe forcat aleatë, për të marrë përgjegjësi më të mëdha.

Për shumë kritikë të administratës Obama, kjo përbën një dështim të udhëheqjes

***Në vend se ta lidhë ndihmën e saj ushtarake për shtetet arabe, me përmbushjen e disa provave të caktuara të gatishmërisë, ndërveprimit, logjistikës, komandës dhe përmirësimit të kontrollit, Uashingtoni i konsumon energjitë e tij, duke e trajtuar shitjen e armëve në një masë të madhe thjesht si transaksion tregtar***

nivel varësie, që të paktën ka mbytur pavarësinë. Obamës, si paraardhëset e vendeve, për të zhvilluar me për mbrojtjen, por në rajmëroi, se Amerika tek kur të zhyten në telashe. shpesh e komplikon këtë pak përgjegjshmëri dhe min aktual të efektivitetit

ndihmën e saj ushtarake me përmbushjen e disa gatishmërisë, ndërvepridës dhe përmirësimit të i konsumon energjitë e tij, jen e armëve në një masë transaksion tregtar. stimuj apo vendosur mancën e dobët, Shtetet e rregullin kryesor, sesi t’i nuk marrin përsipër asnjë qeveria amerikane ka patur ambicioze, duke lënë pas jeshtë: përballë qeverive të si dhe shoqërive të frag-ratë, trajnimi, dhe pajisjet

amerikane, apo edhe braktisje të partnereve të mëparshëm, në mëshirën e armiqve të tyre rajonale. Dhe pas shumë vitesh, kur aftësitë ushtarake janë atrofizuar apo dështuar të zhvillohen, ndarja e barrës me aleatët, nuk kaq qenë shpesh një kujtim i bukur.

Veçanërisht në frontin ushtarak, aleatët e Amerikës qartazi nuk veprojnë si duhet, sikurse do të kishin bërë Shtetet e Bashkuara, në rast se do t'i kishte marrë përsipër vetë ato detyra. Në Irak, përpjekjet e SHBA-së për të deleguar përgjegjësi, kanë dështuar në mënyrë të qartë dhe detyruar ri-angazhimin në ato konflikte, të cilat administrata me siguri do të kishte preferuar t'i shmangte.

Këto të meta dhe rreziqe janë reale. Por në përgjithësi, qasja e administratës është e shëndoshë. Ajo përfaqëson një kuptim të sofistikuar, sesi Amerika duhet të ushtrojë lidërshtipin e saj në një botë më multipolare dhe një pushteti të shpërhapur. Ajo gjithashtu, pasqyron pranimin e faktit se shumë nga sfidat e sigurisë, me të cilat përballlet Shtetet e Bashkuara, rrjedhin nga qeverisja e dobët, dhe që rezultojnë patologjike-veçanërisht konfliktet etnike, sektare dhe fisnore, nuk janë aq të përshtatshme për zgjidhjen amerikane, siç është kërcënimi më tradicional i agresionit ndër-shtetëror gjatë Luftës së Ftohtë.

Së fundi, koncepti i administratës mbi udhëheqjen, është më i përshtatshëm për një publik, që sipas thujse të gjitha anketave publike, është më shumë në favor të mesazhit të Xhorxh Mekgavërn në vitin 1972: "Kthehu në shtëpi Amerikë!", sesa apelit të Xhon Kenedit në fjalimin e tij inaugurues presidencial në vitin 1961, për "të paguar çfarëdolloj çmimi, mbajtur çdo barrë... për të siguruar mbijetesën dhe suksesin e lirisë".

Më e rëndësishmja, burimet dhe kapacitetet e kufizuara në një botë të konkurrentëve në rritje, do të thonë se Shtetet e Bashkuara kanë pak zgjedhje, përveçse për t'u përballur me këto rreziqe. Në shumicën e krizave dhe konflikteve, me të cilat Shtetet e Bashkuara ballafaqohen në Lindjen e Mesme, të mos bësh asgjë, nuk është shpesh një opsion i zbatueshëm politikisht.

Në të njëjtën kohë, ndërhyrja ushtarake amerikane në shkallë të gjerë, nuk është as politikisht e realizueshme dhe as moralisht e mbrojtshme, ndërsa rrezikon të shkallëzojë dhunën. Por pavarësisht sa e kushtueshme është për Shtetet e Bashkuara, të trajnojë dhe të pajisë partnerët e huaj, do të ketë një kosto shumë më të shtrenjtë, angazhimi i drejtpërdrejtë i forcave amerikane.

Dhe kostot e Amerikës mbi reputacionin, besueshmërinë, dhe prestigjin janë më të mëdha, kur forcat amerikane dështojnë të përmbushin misionin e tyre, sesa kur dështojnë partnerët e huaj. Shtetet e Bashkuara, nuk duhet të presin gjithnjë që aleatët të bëjnë mirë, ose pikërisht atë që ajo dëshiron. Por, duke marrë në sy rreziqe të till, është i nevojshëm ndërtimi i kapaciteteve të vërteta.

Frustrimi amerikan me aleatët, që nuk paguajnë asnjë kosto, nuk është një problem i ri. Në fakt, është e vështirë të kujtohet një kohë, kur një administratë amerikane nuk është ankuar mbi këtë dukuri. Administrata Obama, është me të drejtë më pak tolerante, ndaj këtyre përpjekjeve të pamjaftueshme dhe më pak e gatshme, për t'i nxjerrë këto vende nga kjo situatë, sepse pranon që problemi i partnerëve të dobët dhe jo të besueshëm, është bërë shumë më akut.

Së fundmi, SHBA ka një diferencë të madhe mbi sigurinë, dhe mund të përballojë t'i marrë përsipër këto rreziqe, në një periudhë afatshkurtër. Për sigurinë e saj afatgjatë, ajo duhet t'i marrë në sy këto rreziqe, sepse siç tregon me bollëk përvoja, askush nuk do të ndërtojë realisht kapacitete, në rast se nuk ka një rrjet sigurie.

**\* Shënim: Richard Sokolsky është bashkëpunëtor kryesor në "Carnegie Europe", ndërsa Jeremy është drejtues ekzekutiv i "Brookings Institute"**



# Kujdes nga simpatizantët e autokratëve

*Në epokën e pas-Luftës së Ftohtë, të djathtët madje edhe disa në të majtë, janë duke luajtur një lojë të re: “Kush është diktatori juaj i preferuar?”*

NGA JOHN FEFFER  
“INSTITUTE FOR POLICY STUDIES”

Ideologët e krahut të djathtë mbështetën udhëheqës autoritarë si Augusto Pinoçeti i Kilit, ndërsa ideologët e krahut të majtë u thurrnin himne udhëheqësve komunistë, si Fidel Kastro i Kubës. Njëra palë përfaqonte shahun e Iranit dhe Ferdinand Markosin e Filipineve si “këlyshët tanë”, dhe pala tjetër glorifikonte Brezhnjevën, Maon apo Mugabën e Zimbabves, si “njerëz të popullit”. Shumë njerëz në të dyja anët e spektrit politik, nuk pranuan ta luajnë këtë lojë, veçanërisht ata që kishin si prioritet të drejtat e njeriut, mbi atë që u cilësua si realpolitika. Dhe kjo nuk ishte pikërisht një tërheqje e balancuar nga lufta, pasi e djathta ka qenë në qeveri, kur SHBA është tërhequr nga konflikte të ndryshme. Por megjithatë loja ka vazhduar, me të dyja palët që rrekeshin të argumentonin



mbështetjen e tyre ndaj diktatorëve me vlerat e mirënjohura të demokracisë dhe vetëvendosjes së popujve. Edhe kur Lufta e Ftohtë përfundoi dhe turbulloi spektrin politik, kjo lojë rezistoi.

Për shembull, shumë të djathtë janë të kënaqur me familjen mbretërore në Bahrein apo Shtëpinë e Saudëve në Arabi, sepse këta janë aleatët kryesorë të SHBA-së në Lindjen e Mesme (edhe pse disa neokonservatorë, do të donin të shihnin që përpjekjet amerikane të fokusoheshin, tek promovimi i demokracisë dhe zhdukjes së rregjimit të sheikëve).

Dhe në qoftë se gërmojmë më shumë, do të gjejmë disa dinosaurë në të majtë, të cilët ëndërrojnë rikthimin e Stalinit, apo vazhdojnë të lëvdojnë kredencialet anti-koloniale dhe afrikanët e mplakur, dikur revolucionarë por të kthyer shumë shpejt në despotë.

Por kushtet e lojës, kanë ndryshuar. Lojtarët dikur mund të identifikoheshin nga ideologjitë e tyre sistemike - për shembull preferenca ndaj tregut të lirë apo përqafimi i një forme të kolektivizmit. Por tregu i lirë tashmë është kudo, dhe komunizmi në thelb nuk ndodhet askund (madje as në Kinë, apo në Kubë).

Pra, kur ata që qëndrojnë në krah të Vladimir Putinit, Abdel Fatah El-Sisit apo Bashar Al-Asadit, përdorin një grup të ndryshëm argumentash. Simpatizantët e autoritarëve në të djathtë, shqetësohen se autokratët e tyre të preferuar do të zëvendësohen nga fanatikë anti-perëndimore. Ndërkohë, ata në të majtë, e justifikojnë me shigjetën e fundit që kanë: - imperializmin.

Megjithatë, ajo që është me të vërtetë mbresëlënëse, mbi versionin e pas Luftës së Ftohtë të kësaj loje të vjetër, është se ndonjëherë simpatizantët e autoritarizmit në të majtë dhe të djathtë, mbështesin deri në fund të njëjtin diktatorin.

Mbështetësit e Asadit

Përveç grupit kryesor të përkrahësve brenda Sirisë, dhe disa mbështetjeje instrumentale nga Rusia dhe Irani, Bashar Al-Asadi ka një bazë mjaft të dobët tifozësh. Ai është një diktator i pangjyrë, me asnjë ideologji të caktuar, përtej mirëmbajtjes së regjimit dhe mbijetesës personale. Ashtu si shumë prej të ngjashmëve të vet, ai i orkestroi zgjedhjet për t'i dhënë presidencës së tij një mbulesë demokratike.

Ai ka vetëm një argument, të bindë njerëzit brenda dhe jashtë vendit të tij mbi meritat e tij: pas meje, qameti. Dhe ky rrëmet, ujërat e të cilit janë përhapur tashmë në të gjithë pjesët e vendit, mund të vijë në forma të ndryshme: Al-Kaeda, Shteti Islamik, ushtria e sapoformuar e pushtimit, etj. Për këtë arsye, nuk është çudi që Asadi ka mbështetjen e Iranit (i frikësuar e militantizmi sunit), Rusia (e frikësuar nga militantizmi islamik), dhe disa ndihmësve të Kisingerit (të frikësuar nga çfarëdolloj militantizmi, por në tërësi nga kaosi) në Shtetet e Bashkuara.

Asad gjithashtu vjen nga një mjedis i caktuar politik - tradita Baathiste - që ka më shumë se një nuancë fashizmi në përbërjen e saj. Prandaj nuk është çudi që neo-fashistët në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara - Fronti Kombëtar në Francë, Partia për Pavarësinë e Britanisë, Agimi i Artë dhe Zambaku i Zi në Greqi, David Duke në Shtetet e Bashkuara - e mbështesin këtë njeri.

Ata mendojnë se Asadi, është duke i rezistuar trinisë të tmerrshme të Sionistëve, Islamit Radikal, dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Megjithatë, ajo që është për t'u habitur, janë të majtët të cilët tërhiqen nga Asadi. Edhe ata në thelb e mbështesin rregjimin e tij, për të njëjtat arsye: gatishmërinë e Asadit për të rezistuar kundër Shteteve të Bashkuara dhe fuqive të tjera të botës.

Sikurse u shpreh një nga një komentatorët e shkrimit tim të fundit: Falë Zotit, Siria ka një udhëheqës të ri, inteligjent dhe dinamik.

Pa atë, vendi dhe institucionet do të binin në kolaps, nën sulmet e përzjera të Turqisë, Arabisë Saudite, Katarit, Izraelit dhe në mënyrë të fshehtë nga SHBA".

Argumenti real, është se Siria është në prag të kolapsit, për shkak të Asadit dhe refuzimit të tij për të arritur një marrëveshje me opozitën, fillimisht jo të dhunshme. Por unë jam shumë i interesuar, në lidhje me argumentin e anti-imperiali-

zimit. Asad nuk është i interesuar të qëndrojë kundër Shteteve të Bashkuara apo edhe Izraelit mbi këtë çështje.

Ai do të përmirësonte raportet me të dyja vendet, nëse kjo do të thoshte se mund të mbetet në pushtet - ashtu si babai i tij veptoi në të shkuarën me Tel Avivin dhe Uashingtonin, duke firmosur në vitin 1974 Marrëveshjen e Mosangazhimit. Udhëheqësi aktual i Sirisë, do të mirëpriste një luftë të përbashkët kundër Shtetit Islamik. Për shkak se aleancat e tij anti-perandorake janë prishur, Asadi nuk ka nxitur ndonjë entuziazëm të madh në të majtë. Nuk është kështu për Rusinë e Putinit, që ka një klub shumë më të dukshëm tifozësh.

Një falënderim ndaj Putinizmit

Kur nazistët ushtronin presion ndaj Stalinit në afërsi të mureve të Kremlinit, në Luftën e Dytë Botërore, lideri sovjetik u kundërpërgjigj me fjalimin e famshëm të 7 Nëntorit 1941. Ishte përvjetori i 24 i Revolucionit Bolshevik, kështu që Stalini bëri referencat e nevojshme për “flamurin e Leninit”. Por ai e dinte se zelli revolucionar i rusëve ishte i dobët. Ndaj u mbështet në një taktikë më të vërtetë: bëri apel për të mbrojtur atdheun dhe prejardhjen e udhëheqësve perandorakë si Aleksandër Nevski dhe Dimitri Donskoi. Me ushtarë gjermanë në portat të qytetit, Stalini ra në kthetrat e nacionalizmit rus. Vladimir Putin nuk është Stalini, por ai po zbaton një dredhi të ngjashme.

Putin, është një jetik, një operativ i të gjatë nga prapa, në Gjermaninë dhe ndihmoi në rialeve të inteligjencës në duart është rritur me sistemit të ri post-kontakte të ngushtë botën e biznesit Rusisë, buron nga kanë ndaj politikës rrethana me fat përkoji me rritjen e të naftës dhe galegjitime përndërkombëtar e si një humbëse.

Kur Putin arriti aneksimin të Novorossiya Ukrainës lindore, jen e Bashkimit të llakos frazat e tij

tradicional rus: lavditë e historisë ruse, rëndësia e gjuhës dhe kulturës kombëtare. Ai e ka ulur stekën e pretendimeve: më mirë nationalist sesa internacionalist. Ndërkohë, epoka sovjetike bëhet vetëm një pjesë e procesionit madh historik nga carët, komisarët dhe yje televizivet, duke kulminuar me vetë Putinin. Ky ka instinkte thellësisht konservatore. Evropianët e ekstremit të djathtë e mbështesin atë, për të njëjtën arsye që ata pëlqejnë Asadin: është një mburojë kundër Islamit. Në krye të kësaj, ai nuk ka entuziazëm për Bashkimin Evropian. Pak në projektin e tij, i drejtohet së majtës. E megjithatë, për shkak të keqkuptimit se Putin, është disi balancues i hegemonisë amerikane, disa elemente të majtë janë tubuar rreth tij. Por Putin është etiketuar gabimisht si një anti-imperialist. Atij nuk ia ndjen

***Kur nazistët ushtronin presion ndaj Stalinit në afërsi të mureve të Kremlinit, në Luftën e Dytë Botërore, lideri sovjetik u kundërpërgjigj me fjalimin e famshëm të 7 Nëntorit 1941. Ishte përvjetori i 24 i Revolucionit Bolshevik, kështu që Stalini bëri referencat e nevojshme për “flamurin e Leninit”. Por ai e dinte se zelli revolucionar i rusëve ishte i dobët***

produkt i sistemit sovjetik-KGB-së me një karrierë që ishte stacionuar Lindore në vitin 1989, shkatërrimin e marrëdhënies sovjetike, për të e demonstruesve. Ai kujdes në kuadër të sovjetik, duke krijuar hta me elitën politike sit. Sharmi i tij brenda tërheqja që shumë rusë së “grushtit të hekurt”, që rritja e tij politike, ndjeshme të çmimeve zit, si dhe me ankesën pulllore, se komuniteti kishte trajtuar Rusinë

gumenton në favor Krimea, ose krijimit që përfshin pjesët e ai nuk flet për ringjall-Sovjetik. Ai rrumbullësisht nacionalizmit

mbi shtrirjen e pushtetit të SHBA-së në botë, përveçse kur kjo kufizon ambicjet e tij, të cilat janë të kufizuara në rajonin përreth dhe disa vende më të largëta (të tilla si një bazë ushtarake në Siri).

“Për të majtën amerikane, sigurisht vetëm për ta ekziston imperializmi amerikan? Unë nuk mund ta kuptoj këtë”- tha aktivisti rus i krahut të majtë Ilia Budraitkis, gjatë një interviste për ‘Salon’. “Në Rusi, ka shumë të majtë të cilët gjithashtu besojnë se Rusia është e keqja kryesore në botë, ajo është një perandori reaksionare ndaj dhe duhet të shkatërrohet. Ose, në të njëjtën kohë, ka shumë të majtë që besojnë në një farë mënyre Rusia po i reziston imperializmit amerikan dhe të cilët mbështesin këto ‘republikat’ në lindje të Ukrainës”- nënvizon Budraitkis, duke shtuar se imperializmi mund të vijë si një shumëllojshmëri salcash pikante dhe jo vetëm në formën e “vaniljes” amerikane.

Aksi i antiliberalizmit

Në një shkrim të kohëve të fundit, kam argumentuar se një lloj i ri hibridi politik ka dalë si lojtar dominues në arenën globale: autoritarizmi i tregut. Kjo është ajo që unë e quaj “despotizëm me një fytyrë korporate dhe demokraci kozmetike”, dhe që mund të gjendet në Rusinë e Putinit, Kinën e Xi-së, Hungarinë e Orbanit, Turqinë e Erdoganit, Egjiptin e Al-Sisit si dhe në mesin e disa vendeve të tjera. Ky aksi i ri i antiliberalizmit mund të lidhë një ditë Pekinin, Moskën, Hungarinë dhe ndoshta më gjerë, si një linjë e re trans-siberiane. Në të njëjtën linjë me konvergencën joharmonike antiliberalizmit, simpatizantët e autoritarëve dhe udhëtarët e tyre të ndryshëm, e mirëpresim faktin sesa të fortë dhe drejt vendimtarë janë despotët e rinj: Putin pa këmishë, Xi duke krijuar një infrastrukturë të re globale financiare dhe në dukje nihiliste, Asadi që dërrmon kryengritësit e Shtetit Islamik (së bashku me shumë të tjerë).

Nuk ka demokraci të rëmujshe për ta, apo hollësira që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të njeriut. Ata gjithashtu i mbajnë fshehurazi pishën udhëheqësve me “grusht të hekurt”, edhe në rast se ajo që denoncojnë në mënyrë të hapur është grushti i hekurt i të tjerëve (Obama, Netanjahu, Petro Poroshenko, dhe kështu me radhë). Simpatizantët e autoritarëve mbarojnë për “bastardin” e tyre. Në dekadat pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, shumë prej tyre i mbështetën ndërhyrjet amerikane ushtarake jashtë vendit, me arsyetimet e tyre në zhargonin e të drejtave të njeriut. Kjo u bë një shkollë e “ndërhyrjeve humanitare”. Pas dështimeve në Irak, Libi, Afganistan, Somali, etj – të cilat u shndërruan dhe vazhdojnë të jenë fatkeqësi humanitare - kjo shkollë ka humbur shumicën e dishepujve të saj.

Ne duhet të jemi po aq të kujdesshëm për anën e kundërt: ndërhyrjet jo-humanitare. Janë simpatizantët e autoritarëve, ata që shmangnin vëmendjen nga të drejtat e njeriut dhe katastrofat humanitare, nga supozimi se Perëndimi (Shtetet e Bashkuara, Evropa) është komprometuar në mënyrë të padurueshme nga e kaluara e tij (kolonializmi, lufta, perandoritë).

Ne duke të përdorim të gjitha mjetet për të kritikuar politikën, të shkuarën dhe të tashmen, e fuqive perëndimore. Por ndërkaq duhet të lavdërojmë përpjekjet për të shmangur luftëra dhe dhënies fund të armiqësive historike me Iranin, Kubën, Rusinë dhe vendet e tjera.

Por kjo nuk përjashton Putinin, Kastron, Khamenein, Asadin dhe të tjerët, nga përgjegjësia e tyre për shkeljen e normave ndërkombëtare. Mbi të gjitha, duhet të kemi kujdes nga këngët sirenave të simpatizantëve të autoritarëve, si në të djathtë ashtu edhe në të majtë - sidomos kur ata këndojnë në unison.

Shënim: John Feffer është drejtor i Politikës së Jashtme në fokus, një projekt i Institutit për Studime të Politikave.



# Evropa e përgjumur para katastrofës, njësoj si në 1914-ën

NGA PAUL KRUGMAN

---

**Z**yrtarët amerikanë janë në përgjithësi të kujdesshëm, kur është fjala për ndërhyrjen në debatet e politikave evropiane. Tek e fundit, Bashkimi Evropian është një superfuqi ekonomike në të drejtën e vet - shumë i madh dhe i pasur, që Amerika të ketë një ndikim shumë të drejtpërdrejtë - i udhëhequr nga njerëz të sofistikuar, të cilët si rregull duhet të jenë në gjendje për të menaxhuar punët e tyre.

Prandaj, është befasuese kur mëson se Xhejkkob Lju, Sekretari i Thesarit, paralajmëroi kohët e fundit evropianët, se do të bënin mirë ta zgjidhnin shpejt krizën greke, që të mos ndodhë “një aksident” shkatërrues. Por unë e kuptoj, pse zoti Lju e dha atë paralajmërim.

Një dalje e detyruar e Greqisë nga eurozona, do të krijonte rreziqe të mëdha ekonomike dhe politike, por Europa duket e përgjumur përkundrejt këtij skenari. Pra zoti Lju, ka bërë më të mirën e tij, duke u ofruar si një sirenë alarmi për t’u çuar

në këmbë. Po, aluzioni për librin e fundit të mrrekullueshëm të Kristofer Klark, mbi origjinën e Luftës së Parë Botërore, "Somnabujt", është i qëllimshëm. Ka një ndjenjë të përafërt me vitin 1914, mbi atë që po ndodh, një ndjenjë që krenaria, bezdia, dhe llogaritjet e gabuara, dukshëm po e udhëheqin Evropën drejt humnerës, dhe që mund dhe duhet të shmanget. Është shumë e qartë, se cili është thelbi i një marrëveshje ndërmjet Greqisë dhe kreditorëve të saj. Thjesht, Athina nuk do të marrë më një lumë parash. Më së shumti, do të jetë në gjendje të përfitojë hua një pjesë të interesit, mbi borxhin e saj ekzistues. Nga ana tjetër, Greqia nuk mund dhe nuk do të paguajë të gjithë interesin që vjen për këtë shkak, e lëre më pastaj të paguajë borxhin e saj, sepse kjo do të kërkojë një raund të ri dërmues të masave shtrënguese, çka do të shkaktonte dëme të rënda ekonomike, dhe në çdo rast do të ishte politikisht e pamundur.

Pra, ne e dimë se cili do të jetë rezultati i një negociimi të suksesshëm: Greqia do të detyrohet të krijojë një "tepricë primare" pozitive, por të vogël, që me fjalë të tjera është një rritje e të ardhurave mbi shpenzimet, duke mos përfshirë interesat. Çdo gjë tjetër, duhet të jetë rreth inkuadrimin dhe paketimit. Cila do të jetë përzierja mes uljes të normave të interesit, reduktimit në vlerë nominale të borxhit, dhe ndryshimit të afateve të pagesave? Deri në çfarë mase, Greqia do të reduktojë planet e saj të shpenzimeve, përkundër rënies dakord mbi objektivat e përgjithshme, dhe plotësimin e detajeve më vonë?

Këto nuk janë pyetje të parëndësishme, por janë të një niveli të dytë, dhe nuk duhen marrë me shumë rëndësi. Ndërkohë, alternativa- në thelb largimi i Greqisë nga euro, dhe duke u detyruar të rivendosë monedhën e vet kombëtare, në mesin e një krize bankare - është diçka që të gjithë duhet të duan ta shmangin. Megjithatë, negociatat sipas të gjitha llogarive po shkojnë keq, dhe ka një mundësi reale që e keqja në fakt të ndodhë.

Pse nuk munden lojtarët të arrijnë një marrëveshje reciprokisht të dobishme?

Pjesë e përgjigjes, është mosbesimi reciprok. Greqët ndjejnë, me të drejtë, se për vite me rradhë kombi i tyre është trajtuar si një krahinë e pushtuar, e sunduar nga prokonsuj të pashpirt e të paaftë. Në rast se doni të dini pse, shihni si në peshën e pabesueshme të programit shtrëngues të vendit, ka qenë e detyruar të imponojë dhe dështimin e plotë të këtij program, pikërisht për të dhënë rezultatet e premtuara. Ndërkohë, institucionet në anën tjetër i konsiderojnë grekët jo të besueshëm dhe të papërgjegjshëm; një pjesë e kësaj unë mendoj se pasqyron mungesën e përvojës së koalicionit që mori pushtetin, në sajë të dështimit të masave shtrënguese, por është gjithashtu e lehtë për të parë pse, duke pasur parasysh historinë e Greqisë, është e vështirë t'u besosh premtimeve për reforma. Megjithatë, këtu duket se ka diçka më tepër, sesa mungesa e besimit. Disa lojtarë të mëdhenj, duken çuditërisht fatalistë, të gatshëm dhe madje edhe të shqetësuar

***Pse nuk munden lojtarët të arrijnë një marrëveshje reciprokisht të dobishme? Pjesë e përgjigjes, është mosbesimi reciprok. Greqët ndjejnë, me të drejtë, se për vite me rradhë kombi i tyre është trajtuar si një krahinë e pushtuar, e sunduar nga prokonsuj të pashpirt e të paaftë. Në rast se doni të dini pse, shihni si në peshën e pabesueshme të programit shtrëngues të vendit, ka qenë e detyruar të imponojë dhe dështimin e plotë të këtij program, pikërisht për të dhënë rezultatet e premtuara. Ndërkohë, institucionet në anën tjetër i konsiderojnë grekët jo të besueshëm dhe të papërgjegjshëm***

për t'u marrë me katastrofën - një lloj versioni modern i "frymës së 1914-ës", në të cilën shumë njerëz ishin entuziastë për mundësinë e luftës. Këta lojtarë e kanë bindur veten, se pjesa tjetër e Europës, nuk do t'i kushtonte vëmendje një dalje greke nga euro, dhe se një ngjarje e tillë mund edhe të ketë një efekt të dobishëm, duke treguar koston e sjelljes së keqe.

Por ata janë duke bërë një gabim të tmerrshëm. Edhe në një periudhë afatshkurtër, garancitë financiare që gjoja do të zbusin efektet e një daljes së Greqisë nga eurozona nuk janë testuar, dhe mund edhe të dështojnë. Përtej kësaj, Greqia është, i pëlqen dikujt apo jo, pjesë e Bashkimit Evropian, dhe problemet e saj me siguri do të transmetohen në pjesën tjetër të unionit, edhe nëse ngrehia financiare në tërësi reziston.

Së fundmi, grekët nuk janë të vetmit evropianë që janë radikalizuar nga dështimi i politikës. Për shembull në Spanjë, partia kundër masave shtrënguese Podemos, sapo ka korrur një fitore të madhe në zgjedhjet lokale. Në disa aspekte, ajo që mbrojtësit e euros duhet të kenë frikë, nuk është më një tjetër krizë përgjatë këtij viti, por ajo që do të ndodhë, pasi Greqia të fillojë të rimëkëmbet e të bëhet një model për forcat anti- establishment në të gjithë kontinentin.

Asnjë nga këto nuk duhet të ndodhë. Të gjithë lojtarët në tryezë, madje edhe ata që janë më tepër të gatshëm të pranojnë dështimin, kanë qëllime të mira. Vështirë të ketë edhe një konflikt interesi, midis Greqisë dhe kreditorëve të saj - siç thashë, ne e dimë shumë mirë se një marrëveshje reciprokisht e dobishme, do të përfshijë të dyja palët. Por a do të arrihet kjo marrëveshje? Këtë do ta zbulojmë shumë shpejt.

**"New York Times"**



# Tashmë Kina po fillon të vendosë rregullat

NGA PHILIP STEPHENS

---

**N**jë herë e një kohë, punët ishin ndryshe. Jo shumë kohë më parë, politikëbërësit perëndimorë pyesnin nëse një Kinë në rritje, do të shfaqej si një “aktor i përgjegjshëm” në sistemin global të pasluftës. Tanimë, mes polemikave rreth Bankës Aziatike të Investimeve dhe Infrastrukturës, të frymëzuar nga Pekini, ata shtrojnë pyetjen, nëse planet e një Kine në ngjitje për të krijuar një arkitekturë të re ndërkombëtare, mund të ecin qetësisht, së bashku me rendin e themeluar në vitin 1945 dhe të udhëhequr nga SHBA-ja.

Çdokush në Kinë sot, është duke folur për nismën e presidentit Xi Jinping “Një Brez, Një Rrugë”. Askush nuk duket se e di saktësisht se çfarë do të thotë. Ekspertët dhe hartuesit e politikave, të cilët u mblodhën javën e shkuar në Guangzhou, në kuadër të përvjetorit të Forumit kinez të Stokholmit, të organizuar nga “German Marshall Fund” dhe Instituti i Shangait për Studime Ndërkombëtare, bënë një duzinë gjysmë-përshkrimesh dhe interpretimesh.

Të gjithë duket se e kuptojnë, se shtytja perëndimore është basti i madh i zotit Xi, një strategji euroaziatike e madhe, që do të përcaktojë përtej çdo lloj dyshimi, statusin e Kinës si një fuqi globale. Të gjitha gjurmët e mbetura të ngurrimit, që

dikur shënonte rritjen e Kinës janë zhdukur.

Të sugjerosh se Kina, mund të jetë bërë tepër e sigurt në lagjen e saj, është si të shpallësh fajtoreshë se po “mendon sipas shekullit XX-të”.

Mendja e shekullit XXI-të, thotë Pekini, e pranon pushtetin kinez si një fakt të thjeshtë të gjeopolitikës. Sa për pozicionin, prestigjin e tyre, fuqitë e mëdha nuk janë të kënaqura me anëtarësimin tek klubet e vendeve të tjera. Ato fillojnë ndërtimin e klubit të tyre.

Për çudi, “rruga” pjesë e projektit të zotit Xi, nuk ka të bëjë me riaktivizimin e rrugës së lashtë të mëndafshit, por duke zgjeruar dhe siguruar rrugët detare në Lindjen e Mesme dhe Evropë.

Pekini, e ka parë gjithmonë ngushticën e Malakës, si një pikë të rrezikshme asfiksimit. Prandaj, ai synon kontrollin në Oqeanin Indian. Projekti përfshin një bazë detare në Pakistan, dhe një tjetër rrugë detare përmes Mianmarit dhe Bangladeshit. Pekini gjithashtu, po hap rrugën veriore të anijeve drejt Evropës, ndërsa akulli po shkrin në Arktik. Marina, thotë strategjia e fundit ushtarake e Kinës, ka lëvizur përtej mbrojtjes së ujërave në det të hapur drejt “mbrojtjes së detrave të hapur”. Sa për “brezin”, ambicja shtrihet përtej rrugëve të thjeshta dhe hekurudhave –ndonëse zyrtarët janë dukshëm krenarë, për një rrugë të re hekurudhore për mallrat kineze të prodhuara nga Zhengzhou, në një rrugë tokësore përmes Rusisë drejt Hamburgut.

Një paketë ndihme prej 42 miliardë dollarësh ndaj Pakistanit, e premtuar nga zoti Xi, është

mozaikut të marmundësojnë Kinës drejt perëndi-sovjetike të Azisë jisen me stacione industrisë së lehtë one të naftës dhe të kontratave të Një linjë hekurudtradë, do të lidhë Arabik. Lidhjet e të Afrikës dhe të jtojnë procesin e euro-aziatik. Ka një cilësi dilidhje me këtë. në Forumin e se “Një Brez, Një tepër prezantimadhe - një viziontuar si ide organidryshëm objekti-projektesh.

Kësisoj ndihma për Islamabadin, është e nxitur nga dëshira për të kufizuar mbështetjen e ekstremistëve islamikë në Pakistan, ndaj separatistëve ujugurë në provincën Xinjiang. Moria e projekteve të infrastrukturës në rajon, është e nevojshme për të thithur kapacitetin e tepërt industrial të Kinës.

Ky veprim i ashtuquajtur “Stans” i Azisë Qëndrore, është një përgjigje oportuniste ndaj dobësisë ruse, pas aventurës ushtarake të Vladimir Putinin në Ukrainë;po kështu janë edhe marrëveshjet e mëdha të furnizimit me gaz me Moskën. Dhe sigurisht pas çdo gjëje, qëndron domosdoshmëria ekzistenciale për të siguruar furnizimin me burime natyrore dhe energjitike.

***Një paketë ndihme prej 42 miliardë dollarësh ndaj Pakistanit, e premtuar nga zoti Xi, është vetëm njëra pjesë e mozaikut të marrëveshjeve, që do t'i mundësojnë Kinës të shtrijë ndikimin drejt perëndimit. Ish-republikat sovjetike të Azisë Qendrore, do të pajisen me stacione energjitike, fabrika të industrisë së lehtë tekstile dhe tubacione të naftës dhe gazit, në këmbim të kontratave të furnizimit me gaz***

vetëm njëra pjesë e rëveshjeve, që do t'i të shtrijë ndikimin mit. Ish-republikat Qendrore, do të paenergjitike, fabrika të tekstile dhe tubacione gazit, në këmbim furnizimit me gaz. hore dhe supers-Kinën me Detin reja në Kepin Horn Evropës, do të shpeintegrimin ekonomik

çka-për-të gjithë në Kishte nga ata, që Stokholmit, dyshuan Rrugë”, ishte më mi i një strategji të panoptik, i konceptative për një grup të vash, motivesh dhe



Megjithatë aspektet vetjake problematike, të vëna së bashku këto iniciativa, kanë një vlerë më të madhe, sesa të marra secila veçmas. Nëse fuqitë e mëdha, dëshirojnë të ndërtojnë klubet e tyre, ato gjithashtu duhet të vendosin ta shndërrojnë peshën ekonomike në pushtet gjeopolitik. Kina këmbëngul se nisma “Një Brez, Një Rrugë” ka vend për të gjithë, qoftë për Perëndimin apo Azinë Lindore.

Në këtë kuadër, Pekini lëshoi një ftesë të hapur për t’iu bashkuar Bankës Aziatike të Investimeve dhe Infrastrukturës. Uashingtoni e ka bërë veten të duket budalla, duke u përpjekur pa sukses të nxisë një bojkot ndaj bankës së re. Edhe pse gjëja më e rëndësishme për të gjitha inisiativat, është se Kina ka për qëllim të vendosë parametrat.

Sikurse e përcaktoi grupi konsulent me qendër të Londër, Pekini po shfrytëzon të gjithë fuqinë e saj ekonomike, financiare dhe diplomatike, për të nxitur një proces të integritit euro-aziatik, nga territori e tij drejt Lindjes së Mesme, Afrikës dhe Evropës. Kjo e shton jo pak sferën e saj të ndikimit. Natyrisht, ky proces nuk do të vazhdojë pa probleme.

Moska që tani ndihet jo rehat, në rolin e partnerit më të vogël në marrëdhëniet sino-ruse.

Me arsye të justifikuar, ajo është e shqetësuar në lidhje me lëvizjet e Kinës tek ish-Republikat Sovjetike. Divorci me Perëndimin, e ka detyruar zotin Putin ta “shesë” Rusinë me çmim të ulët. Rivalja e vjetër e Kinës, India e ka zgjeruar pratinë e saj detare në Oqeanin Indian.

Kontrollet më të mëdha nga Pekini, nuk do të zbusin rivalitetet dhe konkurrencën për burime, çka ndërlikon situatën në Azinë Qëndrore. Dhe Shtetet e Bashkuara, mund t’i ketë thënë Pekinit, se derdhja e parave në Islamabad, nuk do të blejë ndonjë garanci mbi sigurinë.

Kina nuk po kërkon të përmbysë rendin ekzistues botëror. Gjithësesi, jo ende. Por mesazhi gjeostrategjik, zor se mund të jetë më i qartë. Pekini, synon të jetë më tepër një bërës rregullash, sasa një konsumator i tyre. Edhe pse konkuron me SHBA-në në Azinë Lindore, Kina duket e vendosur për t’u bërë fuqia parësore në Euroazi. Perëndimi duhet të vendosë, nëse do të bëhet një aktor në projektin e dikujt tjetër.

**Financial Times**



# Luftë e Ftohtë pa “dëfrimin” e dikurshëm

NGA THOMAS L. FRIEDMAN

---

**L**e të shohim situatën aktuale: Amerika po i pozicionon tanket e saj të betejës, tek aleatët tanë të NATO-s në Evropës Lindore, si kundërpeshë ndaj Rusisë; Avionët ushtarakë të SHBA-së dhe Rusisë, fluturuan së fundmi më pak se 3 metra larg njëri-tjetrit; Rusia është duke ndërtuar një brez të ri raketash balistike me rreze të gjatë veprimi; dhe SHBA dhe Kina po skërmisin dhëmbët, në Detin e Kinës Jugore.

A e ka rifilluar kush Luftën e Ftohtë, ndërsa unë isha duke kërkuar rrugë të tjera? Nëse është kështu, këtë herë duket si një Luftë e Ftohtë pa dëfrimin e dikurshëm - pra me fjalë të tjera, pa Xhejms Bondin, SMERSH-in e tmerrshëm, kërcitjen e këpucëve të Nikita Hrushovit në sallën e madhe të mbledhjeve të OKB-së, një garë mbi udhëtimin drejt Hënës apo një debat ndërmjet SHBA dhe udhëheqësve sovjetikë, mbi atë se cili vend ka pajisjet më të mira të kuzhinës.

Dhe unë nuk mendoj se do ta shohim presidentin Obama të deklarojë në Kiev, si dikur Presidenti Kenedi në Berlin, “Ich bin ein Ukrainian” (Unë jam një Ukrainas!). Gjithashtu një zhargon i ditëve tona - “një linjë e re diplomatike me Ru-

sinë”, ose “strumbullari i Azisë” - nuk ka asnjë lloj rëndese – përkundrazi jemi larg detantës.

Jo, kjo luftë, post-Luftës së Ftohtë, është më shumë si një ndeshje restlingu - dhe me këtë nuk dua vetëm të them se Presidenti Vladimir Putin i hipën kuajve rusë gjysmë i zhveshur, ndonëse kjo është një metaforë e përshtatshme.

Është vetëm një goditje fshikulluese për pushtet për hir të fuqisë - jo një përplasje e ideve me ndikim, por më tepër e sferave të influencës:

“Ju e kaloni këtë linjë, unë ju dërrmoj hundën”. “Pse?”

“Sepse them unë kështu!” “Ju keni ndonjë problem me këtë?”

“Po, më lejoni t’ju tregoj dronin tim. E keni problem edhe këtë?”

“Jo aspak. Djemtë e mi kibernetikë e vodhën sistemin tuaj të udhëzimeve javën e kaluar nga ‘Northrop Grumman’. “E keni problem këtë punë?” Lufta e Ftohtë kishte një fillim, fund dhe madje edhe një sipar, me rënien e Murit të Berlinit. Por lufta pas-Luftës së Ftohtë, na ka rikthyer sërish në një cikël të plotë para-Luftës së Ftohtë, si dhe lojën e kombeve. Kishte një moment, kur u duk sikur gjithçka do të jetë ndryshe - kur

elitët do të bënin paqe, hej në një sistem më se Rusia do të bëhetës. Kjo epokë i përket Tanimë gazetarët të marrë vizat për të znesmen amerikan me laptopin e tij në Pekin, më shumë të dhëna LinkedIn, Rusia ka pjesë e Evropës - duke dhe një copë atje - dhe (Amerika dhe Gjermania) Pse e gjithë kjo turbu-e parë, kur zgjeruam kufirit rus, edhe pse shembur. Mesazhi hmonë një armik, pa sistemi keni.

Kur çmimet e naftës u marrjen e tij për këtë ai është vetëm duke NATO-s, për të jus-

shoqërisë ruse, në mënyrë që ai dhe shokët e tij kleptokratë të mund të qëndrojnë në pushtet, dhe t’i etiketojnë kundërshtarët e tyre si lakenj të perëndimit. Rrëzimi i udhëheqësit libian Muamar Gadafit nga NATO, Pranvera Arabe dhe protestat në rrugët e Moskës që pasuan, e tronditën Putinin, vë në dukje Sergei Guriev, ekonomisti i njohur rus që tani jeton në Paris. “Putin e kuptoi se e kishte humbur mbështetjen e klasës së mesme ruse, ndaj dhe filloi ta kërkojë legjitimitetin diku tjetër” - tek hipernacionalizmi dhe anti-amerikanizmi. Por Guriev nxjerr në pah një element të rëndësishëm. “Po të mos ishin sanksionet perëndimore ndaj Ruisë, Ukraina Lindore tashmë do të ishte pjesë e Ruisë” - tha ai, duke shtuar se nuk ka frikë më të madhe për Putinin, sesa një Ukrainë që ka sukses në zvogëlimin e korrupsionit dhe ndërtimin e një ekonomie moderne, që do të jetë çdo gjë që Rusia e Putinin nuk është.

Guriev është i shqetësuar, pasi propaganda anti- perëndimore që Putin po pompon në venat e publikut rus, do të ketë një efekt të qëndrueshëm dhe do ta bëjë pasardhësin e tij edhe më të keq. Sido që të jetë, “Rusia do të jetë një sfidë e mad-

***Pse e gjithë kjo turbullirë? Ne dhamë goditjen e parë, kur zgjeruam NATO-n në drejtim të kufirit rus, edhe pse Bashkimi Sovjetik ishte shembur. Mesazhi ndaj Moskës: Ju jeni gjithmonë një armik, pa marrë parasysh se çfarë sistemi keni. Kur çmimet e naftës u rritën, Putin kërkoi hakmarrjen e tij për këtë poshtërim***

dukej se arabët dhe izra-se Kina do të shndërron-konsensual politik, dhe pjesë e Evropës dhe G-8-një të shkuare të largët. perëndimorë luftojnë për shkuar në Kinë, asnjë bitru në kokë nuk e merr pasi hakerat kinezë kanë tuajat personale, sesa ende ndërmend të bëhet aneksuar një pjesë këtu G-8 është tashmë G-1.5 nia).

llirë? Ne dhamë goditjen NATO-n në drejtim të Bashkimi Sovjetik ishte ndaj Moskës: Ju jeni gjithmarrë parasysh se çfarë

rritën, Putin kërkoi hakposhtërim, por tashmë përdorur kërcënimin e tifikuar militarizimin e

he për presidentin tuaj të ardhshëm”.

Udhëheqja kineze nuk është memecë apo e dëshpëruar si Putini - dhe ka nevojë për më shumë qasje në tregjet e SHBA-së - kështu që tani për tani, liderët në Pekin, ende sillen disi në mënyrë të përmbytur në lidhje me pretendimet e tyre mbi Detin e Kinës Jugore.

Por fakt është, sikurse e vë në dukje edhe eksperti për Azinë Endrju Braun në ‘The Wall Street Journal’, “se marrëdhëniet SHBA-Kinë, kanë humbur elementin e tyre strategjik: Bashkimin Sovjetik, kërcënimin e përbashkët që solli bashkëpunimin e dy vendeve”.

Ata kanë krijuar një arsye të re, sa të jenë bashkë- drejtues të stabilitetit global. Me pak fjalë, tërheqja ndaj ekonomisë amerikane dhe kafshimi nga sanksionet e SHBA-së, janë më jetike se kurrë në menaxhimin e lojërave mes kombeve në periudhën e post-Luftës së Ftohtë, duke përfshirë bindjen e Iranit për bisedimet mbi programin e tij bërthamor. Ne mund të rikthehemi tek gjeopolitika tradicionale, por kjo është një botë shumë më e ndërvarur, ku influenza jonë ekonomike, është ende një burim i përmbytjes së Moskës dhe Pekinit. Putin nuk e fsheh më kot përfshirjen e tij ushtarake në Ukrainë; ai ka frikë nga shtimi i sanksioneve bankare nga ana e SHBA-së.

Kina nuk e kufizon më kot sjelljen e saj në Detin e Kinës Jugore; ajo s’mund të rritet pa eksportuar në Amerikë. Pra nuk ka të bëjë vetëm me armët tona; por edhe me gjalpin tonë. Kjo është arsyeja, pse SHBA duhet të zgjerojë marrëveshjet e tregtisë së lirë me Azinë dhe Evropën, dhe ky është gjithashtu motivi pse burimi më i rëndësishëm i stabilitetit në botë sot, është shëndeti i ekonomisë amerikane. Ne mund të ecim të sigurve për sa kohë mbajmë në duar një shkop të madh - dhe një kuletë të madhe.



## Katër lojëra që mund të jenë duke luajtur grekët

*Fatkeqësisht, “loja” që po zhvillohet aktualisht mes Greqisë dhe kredithënësve të saj duke më pak si një ushtrim i sofistikuar në një seminar në Cambridge, dhe më shumë si një skenë e “Rebeli pa kauzë”, ku dy makina nxitojnë drejt një shkëmbi - dhe secili shofer pret që tjetrin ta lënë nervat të parin. Në film, skena përfundon me njërin prej shoferëve që bie në humnerë*

GIDEON RACHMAN

**K**ur e majta radikale mori pushtetin në Greqi në janar, u fol shumë për faktin që Yanis Varoufakis, ministri i ri i Financave, është një ekonomist akademik. Shumëkush priti që strategjia e negociatave e Greqisë do të shfaqte një finesë dhe shkëlqim, tani që udhëhiqej prej bashkëautorit të “Teoria e Lojës: Një hyrje kritike”.

Megjithatë, pas disa muajsh, Greqisë po i mbarojnë miqtë dhe paratë. Teksa afrohet momenti i falimentit, edhe disa komentatorë që e simpatizojnë këtë vend, janë të shastisur prej veprimeve të qeverisë së Athinës.

Atëherë, çfarë loje po luajnë grekët? Ja katër hipoteza të mundshme:

Loja 1: Ata po luajnë me bllofin dhe vazhdojnë të mendojnë se mund të fitojnë. Qeveria e Tsiprasit mundet të besojë ende se BE, në fund, nuk do ta tolerojë shpërbërjen e projektit të saj më të rëndësishëm - monedhën e përbashkët europiane. Humbja e prestigjit politik do të ishte shumë e madhe; risqet e pëhapjes së kontaminimit financiar do të ishin shumë të mëdhenj. Por BE nuk do të bëjë

lëshime seriozë, deri në momentin kur të besojë me të vërtetë se Greqia është duke dalë nga Euro. Kështu që, disa prova të kaosit dhe panikut në Athinë, mund të jenë të domosdoshme për të bindur BE-në se fundi i lojës poa fron.

Loja 2: Ata po luajnë me bllofin, dhe vetëm tani po e kuptojnë që i kanë bërë llogaritë gabim. Alexis Tsiprasi dhe partia e tij Syriza janë rishitarë në politikën e lartë të BE-së. Ata i fituan zgjedhjet në janar, duke besuar se mund të fitonin debatin kundër “masave shtrënguese”, si dhe që nëpër Europë, do të gjenin miq që mendojnë si ata. Muajt e fundit kanë qenë një edukim i dhimbshëm me realitetet e politikës europiane. Teoritë e Varoufakisit nuk kanë funksionuar në praktikë, duke e shtyrë atë të ankohet për mungesën e një “teoricieni të aftë të Lojës, në anën e tij”. Por, vetëdijësimi i Syriza-s se duhet të pranojë kushtet e kredidhënësve - ose të largohet nga Euro - ka ardhur rrezikshmërisht vonë.

Loja 3: E gjitha ka të bëjë me mbajtjen e pushtetit në vend. Stili i parregullt negociues i qeverisë greke tradhëton kaosin në Athinë. Pjesërisht, ky është një pasqyrim i mungesës së eksperiencës dhe mungesës së burimeve në ekipin e Syrizas. Por, partia mund të jetë zënë edhe në kurthin e politikës së brendshme në Greqi. Syriza është një parti koalicioni, dhe krahu i majtë ekstrem i partisë mund të shpëputet, nëse Tsiprasi pranon masa shtrëngimi, në këmbim të një marrëveshje të re me kredidhënësit e Greqisë. Elektorati i gjerë mund të jetë gjithashtu jo shumë i impresionuar. Pra, arritja e një marrëveshjeje, mund të shënojë fundin e karrierës politike të

Loja 4: Greqia në Euro. Mes akadeqë kanë këshilluar janë disa, të cilët se Greqia në fund Ata mendojnë se dalë nga spiralja e nëse nuk njih borxhin, dhe ata e çmimi mund të jetë më tepër, një herë një monedhë e re ndihmojë për rrit-së vendit. Disa në se euro dhe BE në dashëm prej eko-ata e refuzojnë. Vështirësia qën-erdhi në pushtet në të opinionit pu-shumica dërrmuese qëndrojnë në Euro. greke, është e një narrativë, ku përpjekje të sinqer-brendësi të moned-të dëbohet nga të të udhëhequr nga

Cila prej këtyre lojërave po luhet në Athinë? Unë dyshoj se elementë të të katërtave po shfaqen. Edhe tani, vendim-marrësit në Athinë po luhaten ndoshta mes Lojës 1 dhe 2 - të bindur në një moment se BE në fund do të pranojë një marrëveshje, të trembur në një tjetër moment, se një marrëveshje e tillë nuk do të vijë. Një pjesë e sjelljes së parregullt të Tsiprasit - si për shembull premtimi për të bërë

***Vështirësia qëndron në faktin se Syriza erdhi në pushtet në një sfond sondazhesh të opinionit publik, që tregonin se shumica dërrmuese e grekëve dëshirojnë të qëndrojnë në Euro. Kështu që, për qeverinë greke, është e rëndësishme të ndërtojë një narrativë, ku Syriza shihet se bën një përpjekje të sinqertë për të qëndruar në brendësi të monedhës së përbashkët - por të dëbohet nga të huajt e paarsyeshëm, të udhëhequr nga gjermanët***

Tsiprasit.

fakt dëshiron të dalë nga mikëve dhe politikanëve Syrizan, padyshim që kanë besuar gjithmonë duhet të dalë nga Euro. vendi i tyre mund të krizës ekonomike, vetëm një pjesë, ose të gjithë dinë që me shumë gjasë, dëbimi nga euro. Për që Greqia del nga Euro, e luhatshme mund të jen e konkureshmërisë Syriza besojnë gjithashtu përgjithësi janë të panomisë “neoliberale”, që

dron në faktin se Syriza një sfond sondazhesh blik, që tregonin se e grekëve dëshirojnë të Kështu që, për qeverinë rëndësishme të ndërtojë Syriza shihet se bën një të për të qëndruar në hës së përbashkët - por huajt e paarsyeshëm, gjermanët.

një pagesë për FMN, dhe më pas vonesa e saj - pasqyron gjithashtu vështirësitë e tij politike brenda vendit. Dhe ndërkohë që grupi i mendimtarëve të Syrizas mund të duan vërtetë që Greqia të largohet nga Euro mund të jetë pakicë, numri i tyre me siguri do të rritet, teksa kriza intensifikohet.

Pasiguria në lidhje me atë çfarë e shtyn përpara Athinën zmadhohet, për arsye se një seri paralele pyetjesh mund të ngrihen, në lidhje me motivet e Brukselit dhe Berlinit. Mund të argumentohet, njësoj, se qeveria e Gjermanisë po luan me bllofin, në pritshmërinë që ka për kapitullimin e Greqisë, apo që ekipi përreth kancelares Angela Merkel i ka bërë gabim llogaritë, kur ka pritur që grekët do të “sillen në mënyrë të arsyeshme”; apo që qeveria gjermane, ashtu si ajo greke, është e zënë në kurthin e politikës së brendshme; apo në fund, që janë të shumtë ata në Gjermani, sidomos në Ministrinë e Financave, të cilët tani dëshirojnë me forcë që Greqia të dalë nga Euro.

Pasiguria në njërin krah të tryezës së bisedimeve vetëm rrit pasigurinë në anën tjetër. Nëse të dy palët mendojnë se llogaritë e palës tjetër po ndryshojnë, atëherë është më e vështirë të bësh një vlerësim të arsyeshëm për atë që nevojitet të bëhet, me qëllim arritjen e një marrëveshjeje.

Fatkeqësisht, “loja” që po zhvillohet aktualisht mes Greqisë dhe kredidhënësve të saj duke më pak si një ushtrim i sofistikuar në një seminar në Cambridge, dhe më shumë si një skenë e “Rebeli pa kauzë”, ku dy makina nxitojnë drejt një shkëmbi - dhe secili shofer pret që tjetrin ta lënë nervat të parin. Në film, skena përfundon me njërin prej shoferëve që bie në humnerë.

**Financial Times**

## Elita e begatë e Athinës ka filluar të ndiejë frikën...



Monedha e përbashkët e kishte bërë më të lehtë blerjen e pronave evropiane dhe dërgimin e fëmijëve për të studiuar jashtë vendit Nga Henry Foy Athinë - Në një mbërmeje të kohëve të fundit, në hotelin "Semiramis" në Athinën e periferisë...

26/06/2015

### MIKROKREDI

- > Financim i shpejtë
- > Norma interesi konkurruese
- > Sigurim jete Falas



### SPECIALE



"Manastiri i Parmës": Të kërkosh lavdinë, në skajet e ngjarjeve të mëdha

25/06/2015

Nga Sohrab Ahmari Dy shekuj pasi morën fund, Luftërat Napoleoniane e kanë humbur pjesën më të



Jemi edhe atje tej: Në universe shumë të largët janë kopjet tona

24/06/2015

Shumë larg prej këtu, në një galaksi që i ngjan shumë Rrugës së Qumështit, ndodhet një



Napoleon Bonaparti, rrugëtimi i gjatë i një Perandori "të lindur"

24/06/2015

Napoleon Bonaparti lindi në Ajaçio, 15 gusht 1769 dhe vdiq në ishullin Shën Elena, më 5 maj



ROMA: E "vranë, apo u vetëvra?

23/06/2015

Janë të shumta hipotezat e formuluar për të shpjeguar rënien e perandorisë romake



Cili është vendi ynë në këtë Botë?

22/06/2015

Historia e species sonë zbulon shumë nga natyra njerëzore. Flotë në studim i madh. Jan



AXUM, ngjitja dhe rënia e një perandorie misterioze

21/06/2015

Thesaret dhe rënia misterioze e mbretërimit afrikan, djepi autoritetit dhe uardi i ruajtjes së

### OFERTË NGA SPITALI AMERIKAN



Çelësi i përmirësimit të suksesshëm është identifikimi i hershëm dhe korrigjimi i problemeve të syrit!

Vizita okulist Fundus oculi Përcaktim refraksioni Matja e tensionit të syrit Tomografi optike Fushë vizive <b>5000 lekë</b> <small>(për 30 vjeç)</small>	Vizita okulist Fundus oculi Përcaktim refraksioni Matja e tensionit të syrit Topografi korneale Bilanc ortoptik <b>5000 lekë</b> <small>(për 30 vjeç)</small>
---	--

Për një shikim të plotë dhe të qartë, porandalo në kohë!



A mund të ketë sukses plani i ri grek? Masat dhe reformat e propozuara nga Athina janë



Të gjithë jemi të barabartë. Por disa, janë gjithmonë më të barabartë se të tjerët...